

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

Departamenti: AGROEKONOMI

Drejtimi: Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit



## **PUNIM DIPLOME**

(Studime Master)

Vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik që ndikojnë në vendimin e konsumatorëve për blerjen e produkteve të qumështit me vaj bimor në Rrafshin e Kosovës.

Mentor: Prof. Ass. Dr. Arben MUSLIU

Kandidati: Bsc. Shpat AHMETI

Prishtinë, 2021

## DEKLARATË

Me anë të kësaj deklaratë, unë Shpat Ahmeti deklaroj me ndërgjegje të plotë që kjo tezë e masterit është kryer si rezultat i punës time dhe të gjitha burimet dhe literatura e përdorur janë të cituara.

## DEDIKIM

Në emër të Zotit, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit .Kjo punë i është kushtuar nga zemra prindërve të mi, gruas dhe djalit tim.

## FALENDERIME

Fillimisht dua ta falënderoj Zotin e Madhërishëm që ma mundësoi të arrijë në këtë moment të veçant të jetës sime.

Falënderim i madh shkon për mentorin tim Prof.Asoc. Dr.Arben Musliun i cili për gjatë gjithë kohës ka qenë i gatshëm për të më ndihmuar dhe motivuar për përfundimin e temës së Masterit.

Gjithashtu falënderoj edhe anëtarët e komisionit Prof.Asoc. Dr.Mustaf Pllana dhe Prof. Asst. Dr.Njazi Bytyqi.

Falënderoj edhe të gjithë profesorët dhe asistentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë me të cilët kam punuar përgjatë studimeve të mia, poashtu i falënderoj edhe punonjësit e administratës së studentëve.

I falënderoj gjithashtu të gjithë kolegët e mi të studimeve dhe ju dëshirojë çdo suksesë në jetë.

Dhe në fund falënderoj familjen time të cilët më përkrahën në forma të ndryshme në rrugëtimin tim drejt këtij sukse si të dijës.

## ABSTRAKTI

Çështja e vajit bimor në produktet e qumështit është bërë temë diskutimi pothuajse në të gjithë nivelin global, andaj edhe në vendin tonë kjo çështje ka filluar të trajtohet me kujdes nga ana e institucioneve përkatëse , industrisë vendore të qumështit, importuesëve të tyre dhe si më të rëndësishmin faktor atë të konsumatorëve si konsumues final i këtyre produkteve.

Duke e pasur parasysh që qumështi dhe produktet e tij janë nga produktet që konsumohen më së shumti nga ana e konsumatorëve për gjatë gjithë vitit në vendin tonë, përmes këtij hulumtimi do të paraqesim një pasqyrë të qartë se cilët janë faktorët kryesor që ndikojnë kryesisht tek konsumatorët në konsumimin e produkteve të qumështit më përbërje të vajit bimor konkretisht të vajit të palmës.

Viteve të fundit vërehet një ndryshim sa i përket vetdijësimit të konsumatorëve për konsumin e produkteve ushqimore andaj një hulumtim i tillë për sjelljen e konsumatorëve në raport me produktet e qumështit me vaj bimor është i domosdoshëm pasi që hulumtime të tilla për këtë tematik mungojnë.

Objektivi kryesorë i kësaj teze është vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik që ndikojnë në vendimet e konsumatorëve për blerjen e produkteve të qumështit me vaj bimor.

Shtrirja e hulumtimit përmes pyetësorëve u realizua në pjesën e Rrafshit e Kosovës, respektivisht në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Gjilan, Viti dhe Kamenicë.

Fjalët kyçe : Vaji bimor(vaji palmës) , faktorët socio-ekonomik , konsumatorët .

## TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATË.....	2
DEDIKIM .....	3
FALENDERIME .....	4
ABSTRAKTI .....	5
TABELA E PËRMBAJTJES.....	6
LISTA E TABELAVE.....	8
LISTA E FIGURAVE.....	9
LISTA E SHKURTESAVE .....	10
KAPITULLI I .....	11
1.HYRJE .....	11
2. Definimi i problemit .....	13
3. Qëllimi i hulumtimit .....	13
4. Rëndësia e hulumtimit .....	14
5. Organizimi i hulumtimit .....	14
5.1 Hipotezat e hulumtimit .....	14
6. Objektivat.....	15
6.1 Objektivi i përgjithshëm .....	15
6.2 Objektivat specifike .....	15
6.3 Pyetjet hulumtuese .....	15
KAPITULLI II .....	16
2. Materiali dhe metodat e punës .....	16
2.1. Analiza e të dhënave .....	16
2.2. Përshkrimi i zonës së studimit .....	16
<b>KAPITULLI III</b> .....	17
3.RISHIKIMI I LITERATURES.....	17
3.1.Origjina e vajit të palmës .....	17
3.2 Plantacionet e palmës.....	17
3.3 Mekanizmat kryesore të zhvillimit të vajit të palmës .....	18
3.4 Zhvillimi i industrisë të vajit të palmës.....	19
3.4.1 Eksportuesit kryesorë të vajit të palmës.....	20
3.4.2 Importuesit kryesorë të vajit të palmës .....	21
3.5 Konkurrenca e produkteve të vajit.....	22

3.6 Përdorimet e produkteve të palmës vajore .....	23
3.6.1 Përdorime të ngrënshme .....	23
3.6.2 Cilësia e vajit të palmës në përdorime të ngrënshme.....	24
3.7 Shëndeti dhe vetitë e vajit të palmës dhe përbërësve të tij .....	25
3.8 Përdorimi i vajit të palmës në Kosovë .....	28
3.8.1 Importi i vajit të palmës në Kosovë .....	29
3.8.2 Përdoruesit kryesorë të vajit të palmës .....	30
<b>KAPITULLI IV</b> .....	31
<b>4.REZULTATET DHE DISKUTIMET</b> .....	31
4.1.Përshkrimi i rezultateve .....	31
4.1.1 Njohuritë e të anketuarëve për vajrat bimore në bazë të nivelit të tyre arsimor .....	31
4.1.2 Ndikimi i të ardhurave në zgjedhjen e produkteve të qumështit .....	33
4.1.3 Shikimi i përmbajtjes së produkteve në bazë të nivelit të arsimimit .....	37
4.1.4 A është i dëmshëm për shëndetin vaji i palmës dhe çka mund ta bëjë të dëmshëm....	38
4.1.5 Informacionet për vajin e palmës.....	40
4.1.6 Preferencat dhe faktori përcaktues për zgjedhjen e produkteve vendore apo të importit .....	43
4.1.7 A e fshehin prodhuesit vendor përmbajtjen e vajit të palmës dhe te cili produkt ka më shumë përmbajta të tillë .....	44
4.1.8 A ndikon në zgjedhjen e konusmatorëve përmbajtja e vajit të palmës dhe cila është arsyeja e përdorimit të vajit të tillë .....	46
4.1.9 A duhet të jenë në raftet e njejta produktet me vaj palme dhe a duhet të jetë shqetësuese vendojsa në raftet e njejta.....	48
4.1.10 Cilësia e produkteve të qumështit dhe kush duhet të ofroj më shumë siguri për to ..	50
<b>KAPITULLI V</b> .....	52
<b>5.KONKLUZIONE</b> .....	52
<b>REFERENCAT</b> .....	55
<b>ANEKS</b> .....	56
<b>PYETËSORI</b> .....	56

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Eksportuesit kryesorë të vajit të palmës në nivel global për vitin 2019 .....	20
Tabela 2. Importuesit kryesorë të vajit të palmës në nivel global për vitin 2019 .....	21
Tabela 3. Informacionet për vajrat bimore në bazë të nivelit arsimor.....	31
Tabela 4. Testi i Hi K4Tabela 4 Testiatorrit për variablat : Nivelit i arsimimit* A keni informacioneve për vajrat bimore.....	32
Tabela 5. Testi i Hi Katrorit për variablat :Gjinia* A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit.....	34
Tabela 6. Testi i Hi Katrorit për variablat :Sa janë shpenzimet e juaja për blerjen e produkteve të qumështit* A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit.....	36
Tabela 7. Gjatë blerjes a e shikoni përmbajtjen e produkteve?*Niveli i arsimimit.....	37
Tabela 8. Testi i Hi-Katrorit për variablat “Nivelit të arsimimit”*“Gjatë blerjes a e shikoni përmbajtjen e produkteve”.....	38
Tabela 9. Testi i Hi Katrorit për variablat : A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?*Cka mund ta bëjë të dëmshëm për shëndetin? .....	39
Tabela 10. Testi i Hi Katrorit për variablat: A mendoni që vaji I palmës është I dëmshëm?* Informacionet nga cilat burime i keni? .....	41
Tabela 11. A keni informacione për vajrat bimore? * A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm? .....	41
Tabela 12. Testi Hi-Katrorit për variablat . A keni informacione për vajrat bimore? * A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm .....	42
Tabela 13. Testi i Hi Katrorit për variablat: Preferoni produktet e qumështit vendore apo të importit?*Faktori përcaktues për zgjedhjen e produktit vendor apo të importit?.....	44
Tabela 14. Testi Hi-Katrorit për variablat A mendoni që prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës*Te cili produkt keni parë përmbajtje të tillë? .....	45
Tabela 15. Testi Hi-Katrorit për variablat A ndikon në zgjedhjen e juaj përmbajtja e vajit të palmës?*Cila mund të jetë arsyeja e përdorimit të vajit të tillë? .....	47
Tabela 16. A duhet të jenë këto produkte në rafte të njejta ?*A është shqetësuese nëse janë të vendosura në rafte të njejta? .....	48
Tabela 17. Testi Hi-Katrorit për variablat . A duhet të jenë këto produkte në rafte të njejta ?*A është shqetësuese nëse janë të vendosura në rafte të njejta?.....	49



Tabela 18. A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre? * Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor? .....	50
Tabela 19. Testi Hi-Katrorit për variablat . A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre? * Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor?.....	51

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Rritja e prodhimit global të vajit të palmës .....	18
Figura 2. Përdorimi i vajit të palmës.....	23
Figura 3. Ndikimi i të ardhurave në zgjedhjen e produkteve të qumështit në bazë të gjinisë. ....	33
Figura 4. Shpenzimet mujore për blerjen e produkteve të qumështit dhe ndikimi i të ardhurave në zgjedhjen e tyre. ....	35
Figura 5. A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?*Cka mund ta bëjë të dëmshëm për shëndetin? .....	38
Figura 6. A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?*Informacionet nga cilat burime i keni? .....	40
Figura 7. Preferoni produktet e qumështit vendore apo të importit?*Faktori përcaktues për zgjedhjen e produktit vendor apo të importit? .....	43
Figura 8. A mendoni që prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës?*Te cili produkt keni parë përmbajtje të tillë? .....	44
Figura 9. A ndikon në zgjedhjen e juaj përmbajtja e vajit të palmës?*Cila mund të jetë arsyeja e përdorimit të vajit të tillë?.....	46

## LISTA E SHKURTESAVE

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

AVUK - Agjencia e Veterinarisë dhe Ushqimit të Kosovës

BE - Bashkimi Evropian

DPMB - Departamenti i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve

IBK - Instituti Bujqësor i Kosovës

IKSHP - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

MBPZhR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

OBSH – Organizata Botërore e Shëndetësisë

FAO – Organizata e Ushqimit dhe e Bujqësisë

EFSA – Autoriteti Evropian për Siguri Ushqimore

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

PHVO – Vajrat e perimeve pjesërisht të hidrogjenizuara

Tfa – Acidet transydyrore

SFA – Acidet yndyrore të ngopura

VFA – Acidte yndyrore të pangopura

# KAPITULLI I

## 1.HYRJE

Përdorimi i qumështit nga njeriu është njohur që në lashtësi. Njeriu me shtëpizimin e kafshëve filloi të përdor qumështin për ushqim.

Më vonë ai filloi të përgadisë djathin , gjalpin , gjizën ,dhe produktet e tjera të qumështit.

Por, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar ashtu si të gjitha shkencat e tjera, pësoi një zhvillim të fuqishëm edhe industrira e qumështit. Një shtytje këtij zhvillimi i dha mikrobiologjia dhe kimia ku nga përpunimi artizanal i qumështit u kalua në përpunimin industrial.

(Evgjeni Papazisi, 1996)

Në Kosovë qumështi është një produkt bazë i cili është pjesë e çdo familjeje. Qoftë si produkt i parë, qoftë i përpunuar në produkte të tjera, kërkesa për qumësht është gati gjithmonë stabile dhe nuk ndryshon. (Indep, 2015)

Qumështi dhe produktet e tij, hyjnë në grupin e të mirave bazë dhe kanë një konsum të përditshëm. Kërkesa për qumësht ka shënuar rritje të madhe në vitet e pasluftës. Vetëm nga viti 2005 deri në vitin 2013 kjo kërkesë është vlerësuar të jetë rritur për 28%.

Kjo rritje ka qenë stabile dhe sektori në përgjithësi shënon një stabilitet sa i përket kërkesës ekonomike. (Miftari, 2009)

Kur jemi tek kërkesa për qumësht dhe produkte të tij, mungojnë statistika të vazhdueshme mbi sjelljen konsumatore. Edhe pse për 78% të konsumatorëve ka rëndësi që origjina e produktit të jetë vendore, kualiteti, siguria, shija dhe çmimi ishin komponentët më të rëndësishëm që ndikonin në përzgjedhjen e produkteve. Pra, në listën e komponentëve më të rëndësishëm që përcaktojnë përzgjedhjen e produktit, origjina e tij është më pak e rëndësishme sesa kualiteti, siguria, shija dhe çmimi. (Indep, 2015)

Bazuar në vlerësimin e konsumit të përgjithshëm vendor të produkteve të qumështit, është llogaritur konsumi mesatar për kokë banori. Konsumi për kokë banori i qumështit dhe produkteve të qumështit në Kosovë është 228 kg / vit, gjë që sjell Kosovën mes vendeve me

nivele të larta të konsumit. Krahasuar me vendet e tjera të rajonit, Kosova vjen mbi Kroacinë (217 kg / vit), Maqedonia 137.1 (kg / vit), Bullgaria (151.7 kg / vit), Bosnja (196.6 kg / vit), Serbia (154.9 kg / vit ), por më e ulët se Shqipëria (281 kg / vit), Mali i Zi (304.4 kg / vit) dhe Greqia (314.6 kg / vit). (Gap, 2016)

Në Kosovë çmimi vendor nuk është konkurrues me çmimin e produkteve të importuara të cilat hyjnë në treg në mënyrë joligjore si të dampuara, subvencionuara apo me përmbajtje bimore dhe të shitën si produkte shtazore.

Veprimet e këtilla të eksportuesve kanë për qëllim që së pari të hyjnë në treg me çmime nën koston e prodhimit dhe përmes kësaj të dekurajojnë prodhimin vendor. Këto praktika janë në kundërshtim me ligjet e Kosovës për tregti të lirë. (Gap, 2016)

Produktet të cilat janë të përbëra nga qumështi dhe kanë të zëvendësuar yndyrën shtazore me atë bimore duke e përfshirë edhe vajin e palmës, nuk janë ilegale përderisa deklarohet në etiketë përbërja e produktit dhe produkti si i tillë nuk emërtohet si “qumësht” ose “djath” me ç’rast do të konsiderohej si hutim i konsumatorit. (Veterinarisë, 2018)

## 2. Definimi i problemit

Çështja e vajit bimor në produktet e qumështit është bërë temë diskutimi pothuajse në të gjithë nivelin global, andaj edhe në vendin tonë kjo çështje ka filluar të trajtohet me kujdes nga ana e institucioneve përkatëse , industrisë vendore të qumështit, importuesëve të tyre dhe si më të rëndësishmin faktor atë të konsumatorëve si konsumues final i këtyre produkteve.

Viteve të fundit vërehet një ndryshim sa i përket vetdijësimit të konsumatorëve për konsumin e produkteve ushqimore andaj një hulumtim i tillë për sjelljen e konsumatorëve në raport me produktet e qumështit me vaj bimor është i domosdoshëm pasi që hulumtime të tilla për këtë tematik mungojnë.

## 3. Qëllimi i hulumtimit

Në tregun tonë gjenden produkte që emërtohen si produkte të qumështit ndërsa janë pije me përmbajtje bimore, ku si përbërës kanë vajin e palmës dhe vajra tjera bimore. Këto produkte dhe produktet tjera të qumështit me përmbajtje të yndyës bimore shiten në të njëjtin raft me produktet e qumështit, gjë që konsiderohet manipulim në bazë të nenit 53 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit. (Gap, 2016)

Produktet të cilat janë të përbëra nga qumështi dhe kanë të zëvendësuar yndyrën shtazore me atë bimore duke e përfshirë edhe vajin e palmës, nuk janë ilegale përderisa deklarohet në etiketë përbërja e produktit dhe produkti si i tillë nuk emërtohet si “qumësht” ose “djath” me ç’rast do të konsiderohej si hutim i konsumatorit. (Veterinarisë, 2018)

Andaj qëllimi kryesor i hulumtimit është vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik që ndikojnë në vendimin e konsumatorëve për blerjen e produkteve të qumështit me vaj bimor .Shtrirja e hulumtimit do të realizohet në pjesën e Rrafshit të Kosovës respektivisht në komunat : Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan, Shtime, Ferizaj, Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Gjilan dhe Kamenicë.

## 4. Rëndësia e hulumtimit

Duke e pasur parasysh që qumështi dhe produktet e tij janë nga produktet që konsumohen më së shumti nga ana e konsumatorëve për gjatë gjithë vitit në vendin tonë, përmes këtij hulumtimi do të paraqesim një pasqyrë të qartë se cilët janë faktorët kryesor që ndikojnë kryesisht tek konsumatorët në konsumimin e produkteve të qumështit më përbërje të vajit bimor konkretisht të vajit të palmës.

Analiza dhe vlerësimi i këtyre faktorëve janë më se të domosdoshëm pasi që përdorimi i vajit bimor – vajit të palmës në produktet ushqimore në veçanti në ato të produkteve të qumështit vazhdimisht është duke u rritur.

## 5. Organizimi i hulumtimit

### 5.1 Hipotezat e hulumtimit

Ky hulumtim bazohet në testimin e këtyre hipotezave :

H<sub>0</sub>: Përmbajtja e produkteve të qumështit me vaj bimor ndikon te konsumatorët për blerjen dhe konsumin e tyre.

H<sub>1</sub>: Përmbajtja e produkteve të qumështit me vaj bimor nuk ndikon te konsumatorët për blerjen dhe konsumin e tyre.

H<sub>0</sub>: Konsumatorët janë të vetëdijshëm për efektet shëndetësore me konsumimin e produkteve të qumështit me vaj bimor.

H<sub>1</sub>: Konsumatorët nuk janë të vetëdijshëm për efektet shëndetësore me konsumimin e produkteve të qumështit me vaj bimor.

H<sub>0</sub>: Të ardhurat e konsumatorëve dhe çmimi ndikon në blerjen dhe konsumin e produkteve të qumështit me vaj bimor.

H<sub>1</sub>: Të ardhurat e konsumatorëve dhe çmimi nuk ndikon në blerjen dhe konsumin e produkteve të qumështit me vaj bimor.

## 6. Objektivat

### 6.1 Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm është vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik që ndikojnë në vendimin e konsumatorëve për blerjen e produkteve të qumështit me vaj bimor në Rrafshin e Kosovës.

### 6.2 Objektivat specifike

1. Historiku i zhvillimit të vajit bimor – vajit të palmës në nivel global.
2. Prodhuesit dhe importuesit kryesorë të vajit të palmës.
3. Ndikimi i vajit bimor në shëndetin e njeriut.
4. Përdorimi i vajit të palmës në industrinë e qumështit në Kosovë .

### 6.3 Pyetjet hulumtuese

1. Sa ndikon prezenca e përmbajtjes së vajit bimor në produktet e qumështit për përzgjedhjen e tyre për konsum nga ana e konsumatorëve?
2. Sa ndikon niveli i të ardhurave për konsumin e produkteve të qumështit me vaj bimor?
3. A kanë njohuri konsumatorët për vajin bimor , dhe sa e konsiderojnë të dëmshëm për shëndetin e tyre?
4. A kanë të gjitha produktet e qumështit njoftimin në etiketën e prodhimit përmbajtjen e vajit bimor?
5. Cilat janë veprimet e qeverisë për kontrollin e këtyre produkteve dhe mbrojtjen e konsumatorëve?

## KAPITULLI II

### 2. Materiali dhe metodat e punës

Hulumtimi do të realizohet duke u bazuar në dy lloje të të dhënave :

- 1) Të dhënat primare, të cilat do të mblidhen përmes realizimit të pyetësorit të drejtpërdrejt me konsumatorët. Do të realizohen gjithësejt 150 pyetësor. Pyetësori do të përgaditet nga studenti në bashkëpunim me mentorin e tezës së Masterit.
- 2) Në grupin e të dhënave sekondare dhe terciare do të përfshihen të dhënat që do të grumbullohen nga literatura profesionale, faqet zyrtare të institucioneve, nga raportet e agjencive të ndryshme, publikimet e profesorëve universitar dhe të dhënave tjera nga interneti.

Hulumtimi do të zhvillohet në tre faza:

- a) Faza përgaditore.
- b) Faza e hulumtimit në teren (Pyetësorët).
- c) Faza e përpunimit të rezultateve.

#### 2.1. Analiza e të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave nga terreni, do të krijohet një bazë e të dhënave në programin statistikor SPSS (Statistical Package for the Social Science). Përmes këtij programi do të bëhet leximi i të dhënave nga pyetësorët dhe nxerrja e analizave statistikore.

#### 2.2. Përshkrimi i zonës së studimit

Ky studim do të përfshijë Rajonin e Rrafshit të Kosovës, ku përfshinë Komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës, Lipjanit, Shtimes, Ferizajt, Kaçanikut, Hanit të Elezit, Vitisë, Gjilanit dhe të Kamenicës.

Ku do të realizohen gjithësejt 150 pyetësorë:

Prishtinë: 20 pyetësorë , Fushë Kosovë: 10 pyetësorë, Lipjan: 10 pyetësorë, Shtime: 10 pyetësorë, Ferizaj: 30 pyetësorë, Kaçanik: 20 pyetësorë, Hani i Elezit: 10 pyetësorë, Viti: 10 pyetësorë, Gjilan: 20 pyetësorë dhe Kamenicë: 10 pyetësorë.



## KAPITULLI III

### 3.RISHIKIMI I LITERATURES

#### 3.1.Origjina e vajit të palmës

Palma e vajit (*E. guineensis*) ekziston në formë të egër, gjysmë të egër dhe të kultivuar në tre zona kryesore të ekuatorit tropikal: Afrika, Azia Juglindore dhe Jugore dhe Amerika Qendrore. Pjesa më e madhe e kësaj përhapjeje ka qenë rezultat i zbutjes së saj nga njeriu. Ka fosile, historike dhe dëshmi gjuhësore për një origjinë afrikane të vajit palme. Yndyra e gjetur në një varr në Abydos në Egjipt nga rreth 5000bp mund të ketë qenë vaj palme.

Provat botanike të origjinës amerikane të gjinive të lidhura të palmave sugjerojnë një origjinë të Amerikës së Jugut, dhe ka me sa duket palme të egër në Brazil, si dhe në Afrikë. Kishte polemikë në lidhje me këtë pikë dhe është sugjeruar që palma të transportohej në Afrikë në kohërat para-kolumbiane. (Tinker, 2016)

#### 3.2 Plantacionet e palmës

Dallimi kryesor në zhvillim është midis plantacioneve që punojnë në nivelin 1000 ha ose më lart dhe parcelave të fermerëve prej disa hektarësh, të kultivuara vetëm ose në grupe të vogla. Përveç materialit të tyre më të mirë për mbjellje, plantacionet gjithmonë kanë pasur përparësi ndaj parcelave të fermerëve në prodhimin e sasive të mëdha të materialeve të mallrave, sepse ato bazohen në kontrollin e ngushtë menaxherial të detyrave rutinë të kryera në mënyrë efikase.

Plehërimi i rregullt, mirëmbajtja dhe mbi të gjitha korrja janë thelbësore për të prodhuar rendimente të larta dhe cilësi të lartë, dhe kjo i përshtatet sistemit të plantacioneve. Përveç kësaj, ekziston nevoja thelbësore për një mulli për të nxjerrë vajin dhe bërthamat nga tufat, dhe një plantacion dhe mulli mund të projektohen për të punuar së bashku.

Një tendencë e prirjes drejt pasurive ose pronarëve të vegjël duket se është shmangur në Amerikën Jugore dhe Qendrore, dhe në vend të kësaj, ka pasur më shumë prona private të mesme me mullinj të vegjël të krijuar në vend. Në Kolumbi, 47% e mullinjve në 2010 kishin një kapacitet prej më pak se 15 t / h, dhe mesatarja ishte 21 t / h, krahasuar me një mesatare prej rreth 33 t / h në Malajzi. (Tinker, 2016)

### 3.3 Mekanizmat kryesore të zhvillimit të vajit të palmës

Vaji i palmës është një nga vajrat bimor më të përdorur në botë, i pranishëm në rreth gjysmën e ushqimeve dhe produkteve të konsumit që përdoren shpesh. Prodhimi në të gjithë botën i vajit të palmës është rritur nga 15 milion ton në 1995 në 66 milion ton në 2017.

Zgjerimi i shpejtë në përdorim i atribuohet rendimenteve gati katër herë të korrave të tjera të vajit vegjtal, me kosto të ngjashme prodhimi; karakteristikat e favorshme për industrinë ushqimore (pika relativisht e lartë e tymit dhe gjendja gjysmë e ngurtë në temperaturën e dhomës); dhe strategjitë që synojnë të sigurojnë politikat e qeverisë janë mbështetëse për zgjerimin e kultivimit, prodhimit dhe përdorimit të vajit të palmës. (Sowmya Kadandale)

Pemët e palmave të Afrikës Perëndimore dhe Qendrore siguruan lëndën e parë për të filluar një industri të madhe botërore, me pak investime paraprake. Kjo lejoi që tregjet dhe aplikimet për përdorimin e produkteve të palmës të testohen dhe zhvillohen, dhe tregjet në rritje për vajin e palmës gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë çuan në zhvillimin e industrisë moderne të plantacioneve. Kërkesa u rrit me pasurinë e vendeve të zhvilluara dhe u bë logjike të kultivohej palma e vajit duke lënë pak vend ekonomik për bimën e egër ose gjysmë të egër. Rënia e pemëve ishte pra një masë e pjekurisë në rritje të industrisë. (Tinker, 2016)




Figura 1 Rritja e prodhimit global të vajit të palmës

([www.palmoilinvestigations.org/about-palm-oil.html](http://www.palmoilinvestigations.org/about-palm-oil.html), n.d.)

### 3.4 Zhvillimi i industrisë të vajit të palmës

Palma e vajit jep rendimentet më të larta për hektar nga të gjitha kulturat e vajit. Rendimentet e larta kanë çuar në një industri që zgjerohet me shpejtësi në vendet tropikale të Azisë, Afrikës dhe Amerikës.

Vaji i palmës përfaqëson 37% të prodhimit botëror të vajit vegjetal në 2012, ku prodhuesit kryesorë ishin Malajzia dhe Indonezia, e cila siguroi gati 90% të vajit që hynte në tregtinë ndërkombëtare. Fruti i palmës së vajit *Elaeis guineensis* ka një arrë të fortë me lëvore të rrethuar me tul (mesocarp) e cila përmban vaj palme të tregtisë.

Vaji i palmës është ndoshta një nga vajrat më fleksibël në zbatimin e tij, dhe tani është më i madhi burimi i vajit vegjetal.

Malajzia dhe Indonezia kanë krijuar një bazë të madhe të përvojës së vajit të palmës dhe në industrinë ndihmëse të rrjedhës së sipërme dhe të rrjedhës së poshtme, siç janë mbarështimi i bimëve, kultura e indeve bimore, makineritë bujqësore, agrokimikatet dhe fraksionimet e vajit.

Ata tani gjithashtu kanë unitet shoqëror, menaxhim të mirë, zinxhirë furnizimi shumë efikasë dhe reputacion si partnerë të besueshëm në tregti. (Tinker, 2016)

Vendet më të vogla tropikale aziatike dhe amerikane po ndjekin rrugën e nisur nga këto dy vende, dhe kjo rrugë duhet gjithashtu tani ndiqet nga industria afrikane. Industria afrikane ende furnizon një pjesë të madhe të kërkesës së brendshme për vaj, dhe teprica e bërthamave i ka lejuar këto dhe vaji i kernelit të vazhdojnë si një substancë e konsiderueshme tregtia e eksportit.

Industria amerikane e vajit të palmës është rritur në mënyrë të vazhdueshme dhe është vendosur në shumë vende të Amerikës Qendrore dhe Jugore, por në disa mënyra është e ndryshme nga industria aziatike. Një pjesë e prodhimit përdoret në vend, dhe eksportet janë mjaft të vogla.

Amerika e Jugut ka disa sëmundje serioze të palmës së vajit që nuk gjenden diku tjetër. Prodhimi i Amerikës së Jugut ndoshta do të rritet më shpejt në të ardhmen, ashtu si edhe i pjesëve të tjera të Azisë Juglindore ekuatoriale (Tailanda, Papua Guinea e Re), por duhet të kalojë ca kohë para se dominimi i përbashkët i Malajzisë dhe Indonezisë të sfidohet seriozisht. (Tinker, 2016)

### 3.4.1 Eksportuesit kryesorë të vajit të palmës

Vendet aziatike të kryesuara nga Indonezia dhe Malajzia si dy eksportuesit kryesorë gjeneruan të ardhurat të larta nga eksporti i vaji të palmës gjatë vitit 2019 me dërgesa me vlerë 19 miliardë dollarë ose rreth 81 % të totalit global.

Në vendin e dytë ishin eksportuesit evropianë me 7.6% , ndërsa 5.9% të dërgesave në të gjithë botën e kishin origjinën nga vendet e Amerikës Latine duke përfshirë Meksikën, por duke përfshirë Karaibet.

Përqindje më të vogla erdhën nga vendet oqeanë (1.9%) të kryesuara nga Papua Guinea e Re, më pas eksportuesit në Afrikë (1%) dhe Amerikën e Veriut (0.4%).

<b>Eksportuesit kryesorë të vajit të palmës në nivel global për vitin 2019</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Shteti</b>	<b>Vlera e shprehur \$</b>	<b>Vlera e shprehur në %</b>
1	Indonezia	10.4 Miliardë \$	44.80%
2	Malajzia	8.3 Miliardë \$	36.00%
3	Holanda	1.0 Miliardë \$	4.40%
4	Guinea e Re	423.7 Milionë \$	1.80%
5	Kolumbia	402.8 Milionë \$	1.70%
6	Guatemala	393.8 Milionë \$	1.70%
7	Gjermania	265.2 Milionë \$	1.10%
8	Hondurasi	256.8 Milionë \$	1.10%
9	Nepali	189.1 Milionë \$	0.80%
10	Tailanda	147.8 Milionë \$	0.60%
11	Italia	131.0 Milionë \$	0.60%
12	Ekuadori	126.8 Milionë \$	0.50%
13	Danimarka	112.0 Milionë \$	0.50%
14	Kosta Rika	110.9 Milionë \$	0.50%
15	SHBA	87.2 Milionë \$	0.40%

*ITabela 1. Eksportuesit kryesorë të vajit të palmës në nivel global për vitin 2019*

([www.worldstopexports.com/palm-oil-imports-by-country](http://www.worldstopexports.com/palm-oil-imports-by-country), n.d.)

### 3.4.2 Importuesit kryesorë të vajit të palmës

Me zhvillimin e industrisë për gjatë viteve është rritur edhe kërkesa për vajin e palmës dhe ndër vendet që importuan vaj të palmës në nivel global udhëheqen nga vendet Aziatike me Indinë si importuesin kryesorë të vajit të plamës , e ndjekur pastaj nga Kina.Ndërsa si importues kryesorë nga Evropa është Holanda e ndjekur nga Spanja dhe Italia dhe pas tyre si eksportues kryesorë vijnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

<b>Importuesit kryesorë të vajit të palmës në nivel global për vitin 2019</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Shteti</b>	<b>Vlera e shprehur në \$</b>	<b>Vlera e shprehur në %</b>
1	India	5.4 Miliardë \$	21.90%
2	Kina	4.1 Miliardë \$	16.70%
3	Holanda	1.7 Miliardë \$	6.90%
4	Spanja	1.2 Miliardë \$	4.80%
5	Italia	1.1 Miliardë \$	4.30%
6	SHBA	1.0 Miliardë \$	4.10%
7	Rusia	668.0 Milionë \$	2.70%
8	Malajzia	549.3 Milionë \$	2.20%
9	Gjermania	517.5 Milionë \$	2.10%
10	Japonia	498.1 Milionë \$	2.00%
11	Pakistani	458.5 Milionë \$	1.90%
12	Belgjika	376.1 Milionë \$	1.50%
13	Turkia	373.5 Milionë \$	1.50%
14	Korea Jugore	348.7 Milionë \$	1.40%
15	Arabia Saudite	337.4 Milionë \$	1.40%

*Tabela 2. Importuesit kryesorë të vajit të palmës në nivel global për vitin 2019*

Nga vendet e mësipërme, tregjet me rritjen më të shpejtë për vajin e palmës që nga viti 2015 ishin: Spanja (me 36.5%), Koreja e Jugut (me 24.4%), Shtetet e Bashkuara (me 17.1%) dhe Japonia (me 12.6%).Ndërsa vendet që shënuan rënie në blerjet e tyre të vajit të palmës u drejtuan nga: Pakistani (-72,3%), Gjermania (-47,4%), Malajzia (-21.1%) dhe Italia (-11,4%). (www.worldstopexports.com/palm-oil-imports-by-country, n.d.)

### 3.5 Konkurrenca e produkteve të vajit

Prodhimi i vajit të palmës tejkaloi vajin e sojës në 2004 dhe duket se do të mbetet përpara në të ardhmen e parashikueshme.

Përparësia e madhe e vajit të palmës është se rendimenti i vajit për hektar është shumë më i madh se çdo kulturë tjetër të madhe vaji, duke ulur kështu kostot e tokës dhe operacionet për njësi të produktit.

Disavantazhet e vajit të palmës janë kërkesa e lartë e punës dhe jofleksibiliteti: prodhimi i një bime shumëvjeçare nuk mund të ndryshohet aq shpejt sa ai i një kulture vjetore në fermë. Nga 1 vit në tjetrin, një fermer i fasuleve mund të kalojë mes fasule soje dhe misri, në varësi të çmimeve të pritshme.

Materiali i ri i palmës së vajit me rendiment më të lartë po bëhet i disponueshëm, me mbi 10 t vaj / ha në pritje. Bimët e tjera sigurojnë që do të rrisin rendimentin e tyre; të korrat vjetore mund të përmirësohen duke u shumëzuar më shpejt sesa shumëvjeçarët, por është e vështirë të shohësh ndonjë prej tyre që sfidon seriozisht palmën e vajit në këtë drejtim. Pozicioni konkurrues varet nga kostot relative të punës dhe tokës, por palma e vajit është impianti më efikas i akumulimit të vajit. (Tinker, 2016)

Nëse ndryshimet teknologjike që vazhdojnë të përfshijnë shumicën e të korrave të tjera të vajit mund të kenë humbur industrinë e palmës së vajit. Fara e sojës, konkurrenti më i rëndësishëm i vajit të palmës, tregon një rritje e ngjashme me vajin e palmës. Rritja e kërkesës botërore pothuajse me siguri do të thotë që industria globale e palmës së vajit do të mbetet e suksesshme dhe në zgjerim, për aq kohë sa popullsia botërore vazhdon të rritet, ndoshta deri në vitin 2050 më shpejt.

Sidoqoftë, mund të ketë periudha krize të shkaktuara nga çmime të ulëta, dhe konkurrenca midis prodhuesve të ndryshëm të vajit të palmës mund të jetë e fortë.

Industria e vajit të palmës nuk ka mundësi të jetë e vetëkënaqur gjatë ngritjeve të herëpashershme të çmimit dhe duhet të ketë strategji të gatshme për të përmbushur periudha me çmime të ulëta. (Tinker, 2016)

### 3.6 Përdorimet e produkteve të palmës vajore

Këmbyeshmëria e vajrave është rritur vazhdimisht me teknologjinë e lipideve, dhe vaji i përdorur për një qëllim të veçantë shpesh varet nga çmimi aktual dhe disponueshmëria. Gjithmonë ka pasur përdorime të produkteve ushqimore dhe përdorime teknike, por këto të fundit kanë ndryshuar në mënyrë progresive. Vaji me cilësi më të ulët përdoret për qëllime jo të ngrënshme, të tilla si sapunët, rrëshirat, qirinjtë, glicerina, acidet yndyrore, bojërat, lëngjet lustruese dhe produktet kozmetike.




Figura 2. Përdorimi i vajit të palmës

([www.palmoilinvestigations.org/about-palm-oil.html](http://www.palmoilinvestigations.org/about-palm-oil.html), n.d.)

#### 3.6.1 Përdorime të ngrënshme

Vaji i palmës përdoret kryesisht për produktet ushqimore. Rafinimi dhe fraksionimi tani bëhen shpesh në vendet prodhuese. Malajzia ka qenë në ballë të kësaj dhe tani eksporton një gamë të gjerë produktesh të ndryshme, duke përfshirë vaj palme të neutralizuar, vaj palme të rafinuar të zbardhur dhe të deodorizuar (olein palme, stearin palme, vaj të palmës së palmës dhe tortë ose vakt të palmës së palmës), distilat i acidit yndyror të palmës, biovaj dhe një shumëllojshmëri e oleokimikateve dhe produkteve të përfunduara. (Tinker, 2016)

Vaji i palmës është i përshtatshëm për t'u përdorur si yndyrna gatimi dhe vaj për skuqje të thellë, dhe ai shfaqet në produktet e furrave, pjekjet e patates dhe ushqime të tjera, akulloret, krem imitimi dhe produkte të tjera të qumështit dhe margarinë.

Vaji i palmës i modifikuar gjenetikisht me një përmbajtje të rritur të acidit oleik mund të bëhet i disponueshëm me kohë dhe do ta bëjë vajin e palmës akoma më fleksibël për t'u përdorur në ushqime dhe më konkurrues me vajrat e tjerë të ngrënshëm.

Një zhvillim i fundit në prodhimin e kulturave ushqimore është popullariteti i 'ushqimeve organike', i cili ka disa lidhje me konceptin e përgjithshëm të qëndrueshmërisë. Lëvizja organike tani është pothuajse në të gjithë botën dhe po merr deri në disa përqind të tregut të përgjithshëm të ushqimit në disa vende të zhvilluara. Shumica e vlerësimeve shkencore të ushqimit nga kulturat organike arrijnë në përfundimin se nuk ka përparësi ndaj metodave konvencionale të përdorura nga bujqësia e zhvilluar.

Sidoqoftë, ushqimi organik zakonisht komandon një çmim të konsiderueshëm mbi produktin konvencional. Vaji i palmës organike tani prodhohet në Brazil, Kolumbi dhe Ganë.

(Tinker, 2016)

### 3.6.2 Cilësia e vajit të palmës në përdorime të ngrënshme

Cilësia është një atribut i rëndësishëm i produkteve të vajit të palmës dhe është një atribut shumë i rëndësishëm nga pikëpamja tregtare. Mosrespektimi i specifikimeve të cilësisë mund të përfshijë ulje të mëdha ose refuzim të dërgesës nëse nuk mund të përdoret për qëllimin e synuar. Për të matur cilësitë e produkteve të vajit të palmës me një sasi sigurie, metodat e sakta dhe të riprodhueshme janë të rëndësishme.

Disa nga përkeqësimet e cilësisë mund të shmangen nga menaxhimi i duhur i trajtimit, ruajtjes dhe praktikave të transportit nga të gjitha palët e interesuara. Reduktimi i mëtejshëm i rreziqeve të rritjes së tepruar të vlerës së peroksidit (PV) dhe acidit yndyror të lirë (FFA) mund të arrihet pa kryer kosto të larta investimi. Veçanërisht e rëndësishme në të ardhmen, në funksion të faktit se gjithnjë e më shumë vende po shqetësohen gjithnjë e më shumë për aditivët kimikë në produktet ushqimore. (Oi-Ming Lai, Chin-Ping Tan, Casimir C.Akoh, 2012)



### 3.7 Shëndeti dhe vetitë e vajit të palmës dhe përbërësve të tij

Vaji i palmës (*Elaeis guineensis*) është vaji më i madh i ngrënë në botë për sa i përket prodhimit dhe tregtisë. Përbërja e ekuilibruar e acidit yndyror të vajit të palmës (50% e ngopur dhe 50% i pangopur) e bën atë një nga vajrat më të gjithanshëm për aplikimet e industrisë ushqimore. Për më tepër, vaji i palmës së papërpunuar është gjithashtu një nga burimet më të pasura dietike të pro-vitaminës A dhe vitaminës E.

([www.sciencedirect.com](http://www.sciencedirect.com), n.d.)

Studimi i ushqyerjes në lidhje me vajin e palmës ka eksploruar kryesisht përbërjen e tij të acidit yndyror dhe përmbajtjen e mikroelementeve në lidhje me shëndetin dhe sëmundjen. Roli ushqyes i përbërësve të vegjël të palmës ka tërhequr shumë vëmendje. Disa studime ofrojnë prova të forta dhe bindëse se vaji i palmës së kuqe mund të përdoret në mënyrë efektive në artikuj të rregullt të ushqimit për të parandaluar mungesën e vitaminës A. Çmimi konkurrues i vajit të palmës dhe bio-disponueshmëria e mirë e karotenoideve të palmës i japin asaj një avantazh më të madh se vitamina A. sintetike. (Azuan, Z Daud, M Kaur, D & Khosla, P)

Hulumtimi i të ushqyerit në lidhje me vajin e palmës ka eksploruar kryesisht përbërjen e tij të acidit yndyror dhe përmbajtjen e mikroelementeve në lidhje me shëndetin dhe sëmundjen. Vaji i bërthamës së palmës, vaji i palmës dhe fraksionet e tij ndryshojnë në përbërjen e tyre të acideve yndyrore për sa i përket proporcionit të acideve yndyrore të ngopura (SFA) dhe acideve yndyrore të pangopura (UFA).

Përbërja e UFA përfshin acidin oleik (15%) dhe acidin linoleik (~ 3%). Vaji i palmës nga ana tjetër përmban afërsisht sasi të barabarta të SFA dhe UFA. SFA primare është acidi palmitik (45%) së bashku me acidin stearik (5%). (Azuan, Z Daud, M Kaur, D & Khosla, P)

Fakti që vaji i palmës përmban sasi thelbësore të SFA yndyra të ngopura (~ 50%) e tërhoqi atë në qendër të polemikave me të markuar si një yndyrë që rrit kolesterolin bazuar në rezultatet e disa studimeve të hershme. Disa prej tyre krahasuan vajin e palmës si një burim yndyre me vaj / yndyrë tjetër dietik ndërsa studimet e tjera hetonin efektin e SFA individuale.

Kur dieta të rregullta me bazë ushqimi u përdorën në subjekte normokolesterolemike dhe shkëmbimet e acideve yndyrore ishin më realiste (~ 5% e kalorive totale), oleina e palmës

(fraksioni i lëngët nga vaji i palmës), u gjet që jepte vlera të krahasueshme të kolesterolit me vaj ulliri .

Kur fushata kundër vajrave tropikalë (vajit të kokosit, vaji i bërthamës së palmës dhe vaji i palmës) filloi në fillim të viteve 1980, industria ushqimore reagoi menjëherë duke hequr vajin e palmës nga produktet e tyre për të ulur zërin e publikut. Si pasojë, kjo e la industrinë ushqimore me zgjedhje të kufizuara, duke përfshirë përdorimin e vajrave të perimeve pjesërisht të hidrogjenizuara (PHVO) për të ruajtur funksionalitetin dhe shijen, veçanërisht për produktet e pjekura dhe të skuqura.

Në fakt, PHVO ofroi një avantazh superior nga këndvështrimi i industrisë ushqimore pasi ishte shumë i përshtatshëm për të përmbushur nevojat e ndryshme të prodhimit.

Si rezultat, vajrat tropikalë u zëvendësuan përfundimisht nga PHVO që përmbanin acide trans-yndyrore (tFA) në shumicën e zinxhirëve të restoranteve të ushqimit të shpejtë dhe prodhuesve të ushqimeve të përpunuara në Evropë dhe SHBA. Në fund të viteve 1980, u vlerësua në mënyrë konservative që në SHBA, tFA siguron rreth 3% të energjisë totale dietike.

Gjatë 5 viteve të fundit, industria ushqimore ka kërkuar alternativa ndaj PHVO që nuk shkaktojnë efekte të dëmshme shëndetësore, pa sakrifikuar shijen origjinale dhe cilësinë e pjekjes. Aktualisht janë në dispozicion disa opsione, përfshirë yndyrën e interesifikuar, duke përdorur yndyrë të ngopur natyrale nga vajra tropikalë, ose fara vajrash të modifikuar gjenetikisht.

Vaji i palmës mund të përdoren për të gjeneruar raporte 18.0: 16.0.

Kjo modifikon pikën e shkrirjes dhe krijon një vaj që është i përshtatshëm për tiganisje të thellë dhe pjekje. (Azuan,Z Daud,M Kaur,D & Khosla,P)

Karakteristikat ushqyese të vajit të palmës në lidhje me përbërjen e tij të acidit yndyror në lidhje me shëndetin dhe sëmundjen, si dhe nga një pikë e aplikimit të ushqimit, janë studiuar për dekada. Provat aktuale që lidhin trans-yndyrën me çrregullimin metabolik e vendosin vajin e palmës në një avantazh si një zëvendësues alternativ.

Roli ushqyes i përbërësve të palmës ka tërhequr shumë vëmendje. Disa studime ofrojnë prova të forta dhe bindëse se vaji i palmës mund të përdoret në mënyrë efektive në artikuj të rregullt të ushqimit për të parandaluar mungesën e vitaminës A.

Për më tepër, vitamina E e palmës, posaçërisht enolët e tokotrit, janë hetuar për efektet e tyre anti-kancer, anti-trombotik dhe antioksidant që përfshihen në procese të ndryshme të sëmundjes. Megjithëse rezultatet nga studimet paraklinike tregojnë rezultate premtuese, studime të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar një shpjegim dhe udhëzim mekanik për përdorimin praktik të tokotrienoleve në popullatat njerëzore. (Azuan,Z Daud,M Kaur,D & Khosla,P)

Ndërsa këta faktorë të lidhur me vajin e palmës ofrojnë përparësi të qarta për industrinë ushqimore të përpunuar, vaji përmban një përqindje shumë më të lartë të yndyrave të ngopura krahasuar me vajrat e tjerë vegjetalë.

Megjithëse ndikohen ndikimet e saj negative në shëndet, një meta-analizë e rritjes së konsumit të vajit të palmës në 23 vende gjeti një lidhje të rëndësishme me vdekshmërinë më të lartë nga sëmundja ishemike e zemrës.

Një tjetër rishikim sistematik zbuloi se konsumi i vajit të palmës rrit nivelet e gjakut të kolesterolit lipoproteinik me densitet të ulët atherogjen.

Qysh në vitin 2003, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) përshkruan provat që lidhin konsumin e yndyrës së ngopur me rritjen e rrezikut të sëmundjes kardiovaskulare si bindëse. (Kadandale, S Martenb,R & Smithc,R)

Në vitin 2016, EFSA vlerësoi rreziqet për shëndetin publik të tre ndotësve që gjenden në vajrat bimorë dhe ushqimet e përpunuara: esteret e acidit yndyror glikidil (GE), 3-monokloropropanediol (3-MCPD), 2-monokloropropanediol (2-MCPD) dhe acidin e tyre yndyror esteret. Substancat formohen kryesisht kur rafinojnë vajrat vegjetalë në temperatura të larta mbi 200 ° C për të hequr aromat e tyre natyrore, duke i bërë ato të përdorshme si përbërës të ushqimit. Glicidoli (përbërja mëmë e GE) është gjenotoksike dhe kancerogjene, që do të thotë se me kalimin e kohës mund të dëmtojë ADN-në dhe mund të shkaktojë kancer. Ekspozimi ndaj 3-MCPD ka shkaktuar dëmtime të organeve riprodhuese të veshkave dhe meshkujve në testet e kafshëve. Nuk ka informacion të mjaftueshëm për toksicitetin e 2-MCPD kështu që ky raport përmbledh të dhëna vetëm për GE dhe 3-MCPD. ([www.efsa.europa.eu](http://www.efsa.europa.eu))

### 3.8 Përdorimi i vajit të palmës në Kosovë

Edhe në Kosovë , si në çdo vend tjetër të botës përdorimi i vajrave bimore në industrinë ushqimore sa shkon dhe rritet nga viti në vit. Në Kosovë ky vaj ka gjetur një përdorim 80% të gjërë për shkak të kostos (më i lirë) në industrinë ushqimore-konditori: prodhimet e çipsit, biskotave dhe pjekurinave të ndryshme, kurse 20% te prodhimet e qumështit. Nga llojet e vajit bimor që përdoren më së shumti nga këto industri është vaji i palmës.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV) njofton se produktet të cilat janë të përbëra nga qumështi dhe kanë të zëvendësuar yndyrën shtazore me atë bimore duke e përfshirë edhe vajin e palmës, nuk janë ilegale përderisa deklarohet në etiketë përbërja e produktit dhe produkti si i tillë nuk emërtohet si “qumësht” ose “djathë” me ç’rast do të konsiderohej si hutim i konsumatorit.

Kohës së fundit nga Autoriteti Evropian për Siguri Ushqimore është dhënë Opinion për vajrat bimore të procesuara përfshirë edhe vajin e palmës, për veti kancerogjene dhe gjenogjene, kur ato gjatë procesit të prodhimit të tyre arrijnë trajtimin në temperaturë mbi 200 °C. “Për këtë opinion ende nuk janë marrë vendime nga institucionet ndërkombëtare të thirrura për vendimmarrje, nga Komisioni Evropian ose nga vendet anëtare në veçanti por as nga institucione tjera për siguri ushqimore të shteteve të zhvilluara”.

Për derisa nuk merret ndonjë vendim për ndalimin e yndyrërave bimore, përfshirë vajin e palmës në produkte ushqimore nga institucione relevante ndërkombëtare të cilat kanë kapacitete të mjaftueshme për vlerësime shkencore përfundimtare, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë nuk vendosë ndalesë në përdorimin e tyre”.

Megjithatë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë do të vazhdojë me kontrollet zyrtare, shtimin e frekuencës së kontrolleve tek operatorët e biznesit me ushqim dhe mostrimit të produkteve, për të eliminuar dhe parandaluar çfarëdo keqinterpretimi eventual me ushqim në veçanti të produkteve me yndyrë bimore si nga importi ashtu edhe tek prodhuesit vendorë. *Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës për* ([www.ekonomiaonline.com](http://www.ekonomiaonline.com))

Nuk është shqetësuese ajo që paraqitet në opinion, në këtë rast çdo vaj i cili nuk trajtohet në kushtet të cilat kërkohen, gjithmonë edhe mund të paraqet problem. Mirëpo nuk janë vajra të

cilat rrezikojnë shëndetin publik. Në këtë rast edhe sa i përket vajit të palmës, trajtimi i tij në tempertaurë mbi 200 gradë, mund të jetë jo e mirë për shëndetin tonë, por si i tillë ai përdoret ashtu siç e përdorin edhe vendet e bashkimit evropian. Nuk ka ndonjë ndalesë në përdorimin e tij, ngase të gjitha vendet e zhvilluara e përdorin për prodhimin e produkteve ushqimore. Dhe industria ushqimore në përgjithësi, në veçanti prodhimet e kontiterike janë produkte të cilat si shtesa në këtë rast përdoren vajrat bimore. (Veterinarisë, 2018)

Sipas AUV yndyrërat bimore lejohet të përdoren, por nga ana e prodhuesve duhet të deklarohen lidhur me përmbajtjen, cili do produkt që prodhohet.

Vajrat bimore në përgjithësi lejohen të përdoren por duhet të deklarohen nga ana e prodhuesit, është obligim që të deklarojnë mbi përbërjen dhe mbi përmbajtjen e produktit. Në këtë rast edhe yndyra bimore apo vaj i palmës duhet të deklarohet, mandej mbetet në zgjidhjen e konsumatorëve se cilin dëshiron ta blej, atë me yndyrë shtazore apo ai që ka përmbajtje të yndyrës bimore. Roli i agjencisë së Ushqimit dhe inspektorët të agjencisë është kontrolli i sigurisë së produkteve dhe ato produkte të cilat i nënshtrohen një kontrolli të detajuar dhe për të cilat lëshojmë certifikatë janë produkte të cilat janë të sigurta.

( Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës për (<https://ëëë.periskopi.com/vaji-palmes-ne-produktet-e-qumeshtit-shqetesim-serioz-per-institutin-e-shendetit-publik/>))

### 3.8.1 Importi i vajit të palmës në Kosovë

Viteve të fundit kemi pasur rreth 2.5 milionë kilogramë, përkthyer në litra është rreth 2.3 milionë litra brenda një viti import të vajit të palmës. Kurse në vitin 2018 kemi parë një rritje, për shkak se në gjashtëmuorin e parë të këtij viti, periudha janar-qershor e vitit 2018, kemi 1.5 milion import. Nëse vazhdon ky trend atëherë nënkupton që kemi një rritje rreth 25 për qind të sasisë së importuar.

Për tri vjet, nga viti 2015 deri në gjysmën e vitit 2018, janë importuar 6.7 milionë litra të vajit të palmës, që kanë vlerën mbi 5 milionë euro. Ndërsa në vitin 2019 është importuar 3.205 ton vaj palme. Këto importe janë rreth 60% kryesisht nga Malajzia dhe Indonezia , pastaj edhe nga vendet tjera të Bashkimit Evropian.

(Të dhëna zyrtare nga dogana e Kosovës (<https://dogana.rks-gov.net/>))

### 3.8.2 Përdoruesit kryesorë të vajit të palmës

Nga 34 operatorë përpunues të qumështit, sa janë regjistruar në AUV, vetëm shtatë prej tyre janë deklaruar që përdorin vajin e palmës dhe janë shenimet sa kanë stoqe, 73 ton është përdor gjatë vitit 2020 tek operatorët e qumështit. Në konditori janë 29 operatorë nga të cilët 15 përdorin vajin e palmës. Agjencia ka sigurua 37 mostra nga importi dhe 35 vendore, të gjitha kanë rezultuar brenda kriterëve të lejuara sipas deklaracioneve me etiketim, gjatë vitit 2019 kemi 13 mostra nga importi dhe 8 vendore, gjatë vitit 2020 kemi 101 mostra, 79 prodhime vendore dhe 22 mostra nga importi, edhe tash vazhdohet me marjen e mostrave. Të gjitha këto mostra kanë dalur në përputhje me normat dhe standardet e lejuara.

*(Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë (<https://auvk.rks-gov.net/>, n.d.)*

## KAPITULLI IV

### 4.REZULTATET DHE DISKUTIMET

Në këtë kapitull janë prezantuar rezultatet dhe analizat e të dhënave të marra nga 150 pyetësorët e realizuar në Rrafshin e Kosovës, respektivisht në këto komuna: Prishtinë, Fushë Kosovë, Lipjan , Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Hani i Elezit, Viti, Gjilan dhe Kamenicë.

Nga gjenerimi i të dhënave nga pyetësorët përmes programit statistikor SPSS,me metodat Deskriptive (përshkruese) dhe të Hi Katrorit ky seksion jep një pasqyrë të rezultateve të arrituara për vlerësimin e faktorëve socio-ekonomik në blerjen e produkteve të qumështit me përmbajtje të vajit bimor – vajit të palmës.

Rezultatet të cilat janë arritur përmes këtyre metodave do të diskutohen dhe do të paraqiten në vazhdim përmes tabelave dhe grafikoneve.

#### 4.1.Përshkrimi i rezultateve

##### 4.1.1 Njohuritë e të anketuarëve për vajrat bimore në bazë të nivelit të tyre arsimor

		A keni informacione për vajrat bimore?			Total
		Po	Mesatarisht	Jo	
Niveli i arsimimit	Fillor				
	Rezultatet	0.0%	40.0%	60.0%	100.0%
	Mesëm				
	Rezultatet	19.3%	36.8%	43.9%	100.0%
	Bachelor				
	Rezultatet	18.8%	58.8%	22.5%	100.0%
Master					
Rezultatet	62.5%	25.0%	12.5%	100.0%	
Totali	Rezultatet				
	Totali	20.7%	48.0%	31.3%	100.0%

Table 3 Informacionet për vajrat bimore në bazë të nivelit arsimor.(Burimi:Autori)

*Tabela 3.*Paraqet rezultatet e të dhënave nga analiza e variablave se sa kanë njohuri të anketuarit për vajrat bimore në bazë të nivelit të tyre arsimor.

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se të anketuarit:

Me nivel të arsimit fillor 40% prej tyre kanë njohuri mesatare dhe 60% prej tyre nuk kanë njohuri.

Me nivel të arsimit të mesëm nga të anketuarit , 19.30% prej tyre kanë njohuri, 36.80% prej tyre kanë mesatarisht njohuri dhe 43.90% prej tyre nuk kanë njohuri.

Me nivel të arsimit Universitar-Bachelor 18.80% prej tyre kanë njohuri , 58.80% prej tyre kanë mesatarisht informacione dhe 22.50% nuk kanë njohuri.

Me nivel të arsimit Universitar- Master 62.50% prej tyre kanë njohuri , 25% prej tyre kanë mesatarisht njohuri dhe 12.50% prej tyre nuk ka njohuri.

Ndërsa në nivel të përgjithshëm nga 150 të anketuar, 20.70% prej tyre kanë njohuri, 48% prej tyre kanë mesatarisht njohuri dhe 31.3% prej tyre nuk kanë njohuri.

#### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	19.418 <sup>a</sup>	6	.004
Likelihood Ratio	18.139	6	.006
Linear-by-Linear Association	9.909	1	.002
N of Valid Cases	150		

*Tabela 1. Testi i Hi K4Tabela 4 Testiatrorit për variablat : Nivelit i arsimit\* A keni informacioneve për vajrat bimore. (Burimi:Autori)*

Në tabelën numër 4, paraqitet *Testi Hi Katrorit* , ku me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=19.418$  ,  $P=0.004$

Pasi që  $P=0.004(P<0.05)$  , atëherë jemi 99% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të Nivelit të arsimit dhe Informacioneve për vajrat bimore.Andaj themi se niveli i arsimit ndikon te konsumatorët në informacionet që ata kanë për produktet me vaj bimor dhe për konusmin e tyre.



#### 4.1.2 Ndikimi i të ardhurave në zgjedhjen e produkteve të qumështit

##### a) Në bazë të gjinisë




Figura 3 Ndikimi i të ardhurave në zgjedhjen e produkteve të qumështit në bazë të gjinisë.  
(Burimi: Autori)

Grafiku 3 paraqet rezultatet e të dhënave nga analiza e variablave se: A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit në bazë të gjinisë.

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se të anketuarit e gjinisë mashkullore nga 88 të anketuar prej tyre 44 theksojnë se ndikojnë të ardhurat e tyre apo 50% , 30 prej tyre theksojnë se nuk ndikojnë apo 34.1% dhe 14 prej tyre theksojnë se mesatarisht ndikojnë apo 15.9%.

Te gjinia femërore nga 62 të anketuara prej tyre 47 theksojnë se ndikojnë të ardhurat e tyre apo 75.8% , 10 prej tyre theksojnë se nuk ndikojnë apo 16.1% dhe 5 prej tyre deklarojnë se mesatarisht ndikojnë të ardhurat apo 8.1%.

Ndërsa në nivelin e përgjithshëm nga 150 të anketuar : 91 prej tyre deklarojnë se të ardhurat e tyre ndikojnë apo 60.7% , 40 prej tyre deklarojnë që nuk ndikojnë apo 26.7% dhe 19 prej tyre deklarojnë se mesatarisht ndikojnë apo 12.7%.

### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	10.161 <sup>a</sup>	2	.006
Likelihood Ratio	10.473	2	.005
Linear-by-Linear Association	8.135	1	.004
N of Valid Cases	150		

*Tabela 5. Testi i Hi Katrorit për variablat :Gjinia\* A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit.* (Burimi: Autori)

Në tabelën numër 5, paraqitet *Testi Hi Katrorit*, ku me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=10.161$ ,  $P=0.006$

Pasi që  $P=0.006$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant, atëherë jemi 99% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit në bazë të gjinisë të anketuarëve. Andaj themi se Të ardhurat ndikojnë në zgjedhjen e produkteve të qumështit në bazë të gjinisë.

b) Në bazë të shpenzimeve mujore për blerjen e produkteve të qumështit




Figura 4 Shpenzimet mujore për blerjen e produkteve të qumështit dhe ndikimi i të ardhurave në zgjedhjen e tyre. (Burimi: Autori)

Figura 4 paraqet rezultatet e të dhënave nga analiza e variablave se: A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit dhe Sa janë shpenzimet mesatare mujore për blerjen e produkteve të qumështit.

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar, prej tyre 91 deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit dhe prej tyre:

Me mesatare mujore të shpenzimeve 5 deri 10 €/Muaj 7 apo 7.7% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit. Me mesatare mujore të shpenzimeve 10 deri 25 €/Muaj 28 apo 30.8% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit. Me mesatare mujore të shpenzimeve 25 deri 50 €/Muaj 38 apo 41.8% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit. Me mesatare mujore të shpenzimeve mbi 50 €/Muaj 18 apo 19.8% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit.

Nga 150 të anketuar 40 prej tyre deklarojnë që jo nuk ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit dhe prej tyre :

Me mesatare mujore të shpenzimeve 5 deri 10 €/Muaj 4 apo 10% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit.Me mesatare mujore të shpenzimeve 10 deri 25 €/Muaj 16 apo 40% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit.Me mesatare mujore të shpenzimeve 25 deri 50 €/Muaj 19 apo 47.5% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit.Me mesatare mujore të shpenzimeve mbi 50 €/Muaj 1 apo 2.5% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit.

Nga 150 të anketuareve 19 prej tyre deklarojnë që mesatarisht ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit dhe prej tyre :Me mesatare mujore të shpenzimeve 5 deri 10 €/Muaj 3 apo 15.8% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit.Me mesatare mujore të shpenzimeve 10 deri 25 €/Muaj 10 apo 52.6% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit. Me mesatare mujore të shpenzimeve 25 deri 50 €/Muaj 6 apo 31.6% deklarojnë që po ndikojnë të ardhurat e tyre në përzgjedhjen e produkteve të qumështit.

### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	13.546 <sup>a</sup>	6	.035
Likelihood Ratio	16.790	6	.010
Linear-by-Linear Association	9.527	1	.002
N of Valid Cases	150		

Tabela 6. Testi i Hi Katrorit për variablat :Sa janë shpenzimet e juaja për blerjen e produkteve të qumështit\* A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit.(Burimi:Autori)

Në tabelën numër 6, paraqitet Testi Hi Katrorit , ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen e variablave: “Sa janë shpenzimet e juaja për blerjen e produkteve të qumështit\* A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit” ku me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=13.546$  ,  $P=0.035$

Pasi që  $P=0.035$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave A ndikojnë të ardhurat në zgjedhjen e produkteve të qumështit dhe shpenzimeve të tyre mujore në blerjen e produkteve .

#### 4.1.3 Shikimi i përmbajtjes së produkteve në bazë të nivelit të arsimit

Niveli i arsimit * Gjatë blerjes a e shikoni përmbajtjen e produkteve?			Gjatë blerjes a e shikoni përmbajtjen e produkteve?		
			PO	JO	Total
<b>Niveli i arsimit</b>	Fillor	Rezultatet	3	2	5
			60.0%	40.0%	100.0%
	Mesëm	Rezultatet	55	2	57
			96.5%	3.5%	100.0%
Fakultet	Rezultatet	76	4	80	
		95.0%	5.0%	100.0%	
Master	Rezultatet	8	0	8	
		100.0%	0.0%	100.0%	
Totali	Rezultatet	142	8	150	
		94.7%	5.3%	100.0%	

Tabela 7. Gjatë blerjes a e shikoni përmbajtjen e produkteve?\*Niveli i arsimit. (Burimi: Autori)

Tabela 7. Paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat se Gjatë blerjes a e shikojnë përmbajtjen e produkteve në bazë të nivelit të tyre arsimor.

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se të anketuarit me nivel të arsimit fillor 60% prej e shikojnë dhe 40% prej tyre nuk e shikojnë.

Me nivel të arsimit të mesëm prej tyre 96.5% e shikojnë, 3.5% prej tyre nuk e shikojnë.

Me nivel të arsimit Universitar-Bachelor, 95% prej tyre e shikojnë , 5% prej tyre nuk e shikojnë.

Me nivel të arsimit Universitar- Master , prej tyre e shikojnë 100% e të anketuarëve.

Ndërsa në nivel të përgjithshëm nga 150 të anketuar,94.7% prej tyre e shikojne përmbajtjen apo dhe 5.3% prej tyre nuk e shikojnë.

### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2- sided)
Pearson Chi-Square	12.746 <sup>a</sup>	3	.005
Likelihood Ratio	6.643	3	.084
Linear-by-Linear Association	2.592	1	.107
N of Valid Cases	150		

Tabela 8 . Testi i Hi-Katrorit për variablat “Nivelit të arsimimit”\*“Gjatë blerjes a e shikoni përmbajtjen e produkteve”.(Burimi:Autori)

Në tabelën numër 8, paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar variablat: “Nivelit të arsimimit”\*“Gjatë blerjes a e shikoni përmbajtjen e produkteve”.Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=12.746$  ,  $P=0.005$

Pasi që  $P=0.005$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave

Andaj themi se “Niveli i arsimimit ndikon që gjatë blerjes, konsumatorët të shikojnë përmbajtjen e produkteve që ata i blejnë”.

#### 4.1.4 A është i dëmshëm për shëndetin vaji i palmës dhe çka mund ta bëjë të dëmshëm




Figura 5 A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?\*Cka mund ta bëjë të dëmshëm për shëndetin? (Burimi:Autori)

Figura 5 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat: A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm? dhe Cka mund ta bëjë të dëmshëm për shëndetin?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar:

PO është i dëmshëm mendojnë 78 të anketuar dhe prej tyre 28 mendojnë nga Mënyra se si përdoret nga prodhuesit, 25 vetit e saja të dëmshme, 5 konsumi i shpeshtë dhe 20 nuk kanë njohuri se cili është faktori kryesor.

JO nuk është i dëmshëm mendojnë 16 të anketuar dhe prej tyre 4 mendojnë që mund të bëhet i dëmshëm vetëm nga Mënyra se si përdoret nga prodhuesit, 2 vetit e saja të dëmshme, 2 konsumi i shpeshtë dhe 8 nuk kanë njohuri se cili është faktori kryesor.

Nuk kam njohuri mendojnë 56 të anketuar dhe prej tyre 3 mendojnë nga Mënyra se si përdoret nga prodhuesit, 1 vetit e saja të dëmshme, 3 konsumi i shpeshtë dhe 49 nuk kanë njohuri se cili është faktori kryesor.


Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	54.686 <sup>a</sup>	6	.000
Likelihood Ratio	61.465	6	.000
Linear-by-Linear Association	46.995	1	.000
N of Valid Cases	150		

Tabela 9. Testi i Hi Katrorit për variablat : A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?\*Cka mund ta bëjë të dëmshëm për shëndetin? (Burimi: Autori)

Në tabelën numër 9, paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave “A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?\*Cka mund ta bëjë të dëmshëm për shëndetin?”. Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=54.686$ ,  $P=0.000$

Pasi që  $P=0.000$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant, atëherë jemi 99.9% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

#### 4.1.5 Informacionet për vajin e palmës



*Figura 6 A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?\*Informacionet nga cilat burime i keni?*  
(Burimi: Autori)

Figura 6 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat se: A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm për shëndetin?\* Informacionet nga cilat burime i keni?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar:

PO është i dëmshëm mendojnë 78 të anketuar dhe këto informacione 8 prej tyre i kanë nga literatura , 27 nga mediat dhe gazetatat, 43 nga portalet dhe rrjetet sociale

JO nuk është i dëmshëm mendojnë 16 të anketuar dhe këto informacione 4 prej tyre i kanë nga literatura , 2 nga mediat dhe gazetatat, 3 nga portalet dhe rrjetet sociale dhe 7 prej tyre nuk kanë njohuri.

Nuk kam njohuri mendojnë 56 të anketuar dhe këto informacione 1 prej tyre i kanë nga literatura , 9 nga mediat dhe gazetatat, 6 nga portalet dhe rrjetet sociale dhe 40 prej tyre nuk kanë njohuri.

Ndërsa në nivel të përgjithshëm nga 150 të anketuar, 13 prej tyre këto informacione i kanë nga literatura apo 8.7% ,38 prej tyre nga mediat dhe gazetatat apo 25.3%, 52 prej tyre nga rrjetet sociale apo 34.7% dhe 47 prej tyre nuk kane njohuri apo 31.3%.



### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	87.618 <sup>a</sup>	6	.000
Likelihood Ratio	106.562	6	.000
Linear-by-Linear Association	40.752	1	.000
N of Valid Cases	150		

Tabela 10. Testi i Hi Katrorit për variablat: A mendoni që vaji I palmës është I dëmshëm? \*  
Informacionet nga cilat burime i keni? (Burimi: Autori)

Në tabelën numër 10, paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave “A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm? \* Informacionet nga cilat burime I keni?”.

Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=87.618$  ,  $P=0.000$ . Pasi që  $P=0.000$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99.9% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

### A keni informacione për vajrat bimore? \* A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?

		A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?			Total	
		PO	JO	Nuk kam njohuri		
<b>A keni informacione për vajrat bimore?</b>	Po	Rezultati	27	4	0	31
			87.1%	12.9%	0.0%	100.0%
	Mesatarisht	Rezultati	51	5	16	72
			70.8%	6.9%	22.2%	100.0%
	Jo	Rezultati	0	7	40	47
			0.0%	14.9%	85.1%	100.0%
<b>Totali</b>		Rezultati	78	16	56	150
			52.0%	10.7%	37.3%	100.0%

Tabela 11 A keni informacione për vajrat bimore? \* A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?  
(Burimi: Autori)

Tabela 11 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat: A keni informacione për vajrat bimore? \*

A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar:

31 prej tyre deklarojnë se Po kanë informacione për vajrat bimore dhe prej tyre 27 apo 87.1% mendojnë që “Po vaji i palmës është i dëmshëm për shëndetin”, prej tyre 4 apo 12.9% mendojnë që “Jo vaji i palmës nuk është i dëmshëm për shëndetin”.

72 prej tyre deklarojnë se Mesatarisht kanë informacione për vajrat bimore dhe prej tyre 51 apo 70.8% deklarojnë që “Po vaji i palmës është i dëmshëm për shëndetin”, prej tyre 5 apo 6.9% deklarojnë që “Jo vaji i palmës nuk është i dëmshëm për shëndetin”, dhe 16 apo 22.2% deklarojnë që “Nuk kanë njohuri”.

Ndërsa në total nga 150 të anketuar: 78 apo 52% mendojnë që “Po vaji i palmës është i dëmshëm për shëndetin”, prej tyre 16 apo 10.7% deklarojnë që “Jo vaji i palmës nuk është i dëmshëm për shëndetin”, dhe 56 apo 37.3 % deklarojnë që “Nuk kanë njohuri”.

#### Chi-Square Tests


	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	83.272 <sup>a</sup>	4	.000
Likelihood Ratio	110.603	4	.000
Linear-by-Linear Association	71.818	1	.000
N of Valid Cases	150		

Tabela 12. Testi Hi-Katrorit për variablat . A keni informacione për vajrat bimore? \* A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm (Burimi: Autori)

Në tabelën numër 12, paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave *A keni informacione për vajrat bimore? \* A mendoni që vaji i palmës është i dëmshëm?* Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=83.272$  ,  $P=0.000$

Pasi që  $P=0.000$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifkiant , atëherë jemi 99.9% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

#### 4.1.6 Preferencat dhe faktori përcaktues për zgjedhjen e produkteve vendore apo të importit



*Figura 7 Preferoni produktet e qumështit vendore apo të importit?\*Faktori përcaktues për zgjedhjen e produktit vendor apo të importit?Burimi (Autori)*

Figura 7 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat: Preferoni produktet e qumështit vendore apo të importit?Dhe: Faktori përcaktues për zgjedhjen e produktit vendor apo të importit?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar:110 prej tyre deklarojnë për produktet vendore dhe prej tyre faktori përcaktues i përzgjedhjes është:

51 prej tyre deklarojnë Cilësia apo 46.4%, 3 prej tyre Marka apo 2.7%, 30 prej tyre Besueshmëria apo 27.3% , 26 prej tyre Origjina apo 23.6%.

40 prej tyre deklarojnë për produktet e importit dhe prej tyre faktori përcaktues i përzgjedhjes: 35 prej tyre deklarojnë Cilësia apo 87.5%, 4 prej tyre Marka apo 10%, 0 prej tyre Besueshmëria apo 0% , 1 prej tyre Origjina apo 2.5%.

Ndërsa në nivel të përgjithshëm nga 150 të anketuar për faktorin përcaktues deklarojnë:

86 prej tyre Cilësia apo 57.3% , 7 prej tyra Marka apop 4.7% , 30 prej tyre Besueshmëria apo 20% dhe 27 prej tyre Origjina apo 18% .

### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	30.172 <sup>a</sup>	3	.000
Likelihood Ratio	39.633	3	.000
Linear-by-Linear Association	23.906	1	.000
N of Valid Cases	150		

Tabela 13. Testi i Hi Katrorit për variablat: *Preferoni produktet e qumështit vendore apo të importit?\**Faktori përcaktues për zgjedhjen e produktit vendor apo të importit? (Burimi:Autori)

Në tabelën numër 13, paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave “*Preferoni produktet e qumështit vendore apo të importit?\**Faktori përcaktues për zgjedhjen e produktit vendor apo të importit?”.

Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të këtyre variablave  $\chi^2=30.172$  dhe  $p=0.000$ . Pasi që  $P=0.000$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99.9% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

#### 4.1.7 A e fshehin prodhuesit vendor përmbajtjen e vajit të palmës dhe te cili produkt ka më shumë përmbajtje të tillë




Figura 8 A mendoni që prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës\*Te cili produkt keni parë përmbajtje të tillë.(Burimi:Autori)

Figura 8 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat: Te cili produkt keni parë më shumë përmbajtje me vaj palme dhe A mendoni që prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar, përmbajtje të tillë kanë parë tek këto produkte:

Te ajka, 16 të anketuar kanë parë përmbajtje të vajit të palmës. Nga ta 10 prej tyre theksojnë se prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës, ndërsa 6 prej tyre theksojnë që nuk e fshehin.

Te djathi, 32 të anketuar kanë parë përmbajtje të vajit të palmës. Nga ta 21 mendojnë se prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës, ndërsa 11 mendojnë që nuk e fshehin.

Te gjalpi, 17 të anketuar kanë parë përmbajtje të vajit të palmës. Nga ta 12 mendojnë se prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës, ndërsa 5 mendojnë që nuk e fshehin.

Te gjiza, 8 të anketuar kanë parë përmbajtje të vajit të palmës. Nga ta 8 mendojnë se e fshehin prodhuesit vendor përmbajtjen e vajit të palmës.

Te kaçkavalli, 16 të anketuar kanë parë përmbajtje të vajit të palmës. Nga ta 8 mendojnë se e fshehin ndërsa 8 mendojnë që nuk e fshehin.

Prej atyre që nuk kanë parë përmbajtje të vajit të palmës janë 60 të anketuar.

Ndërsa si rezultat i përgjithshëm nga 150 të anketuar 75 prej tyre apo 50% mendojnë që e fshehin prodhuesit vendor përmbajtjen e vajit të palmës, ndërsa 75 prej tyre apo 50% mendojnë që jo .

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	28.794 <sup>a</sup>	5	.000
Likelihood Ratio	32.609	5	.000
Linear-by-Linear Association	17.041	1	.000
N of Valid Cases	150		

Tabela 14 Testi Hi-Katrorit për variablat A mendoni që prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës\*Te cili produkt keni parë përmbajtje të tillë? (Burimi: Autori)

Në tabelën numër 14, paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave “A mendoni që prodhuesit vendor e fshihin përmbajtjen e vajit të palmës\* dhe Te cili produkt keni parë përmbajtje të tillë”.

Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të variablave  $\chi^2=28.794$  dhe  $p=0.000$ .

Pasi që  $P=0.000$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99.9% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

#### 4.1.8 A ndikon në zgjedhjen e konsumatorëve përmbajtja e vajit të palmës dhe cila është arsyeja e përdorimit të vajit të tillë




Figura 9 A ndikon në zgjedhjen e juaj përmbajtja e vajit të palmës?\*Cila mund të jetë arsyeja e përdorimit të vajit të tillë?(Burimi: Autori)

Grafiku 9 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat: A ndikon në zgjedhjen e juaj përmbajtja e vajit të palmës?\*Cila mund të jetë arsyeja e përdorimit të vajit të tillë?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar:

64 prej tyre deklarojnë që arsyeja që një prodhues përdorë vajra të tillë është: Kostoja më e ulët prodhuese. Dhe nga ta 31 apo 48.4% prej tyre deklarojnë që: PO ndikon zgjedhjen e tyre

përmbajtja e vajit të palmës, 18 prej tyre apo 28.1% deklarojnë që mesatarisht ndikon dhe 15 apo 23.4% deklarojnë që jo nuk ndikon.

35 prej tyre deklarojnë që arsyeja që një prodhues përdorë vajra të tillë është: Cilësia më e lartë. Dhe nga ta 5 apo 14.3% prej tyre deklarojnë që: PO ndikon zgjedhjen e tyre përmbajtja e vajit të palmës, 15 prej tyre apo 42.9 % deklarojnë që mesatarisht ndikon dhe 15 apo 42.9 % deklarojnë që jo nuk ndikon.

51 prej tyre deklarojnë që arsyeja që një prodhues përdor vajra të tilla është: Qëndrueshmëria e produktit. Dhe nga ta 12 apo 23.5 % prej tyre deklarojnë që: PO ndikon zgjedhjen e tyre përmbajtja e vajit të palmës, 12 prej tyre apo 23.5 % deklarojnë që mesatarisht ndikon dhe 27 apo 52.9 % deklarojnë që jo nuk ndikon.

Ndërsa në total nga 150 të anketuar 48 apo 32% e tyre deklarojnë që: Po ndikon përmbajtja në zgjedhjet e tyre , 45 apo 30% e tyre deklarojnë që Mesatarisht ndikon dhe 57 apo 38% e tyre deklarojnë që Jo nuk ndikon.

**Chi-Square Tests**

	Value	df	Asymptotic Significance (2-sided)
Pearson Chi-Square	19.480 <sup>a</sup>	4	.001
Likelihood Ratio	19.820	4	.001
Linear-by-Linear Association	12.651	1	.000
N of Valid Cases	150		

*Tabela 15. Testi Hi-Katrorit për variablat A ndikon në zgjedhjen e juaj përmbajtja e vajit të palmës? \*Cila mund të jetë arsyeja e përdorimit të vajit të tillë? (Burimi: Autori)*

Në tabelen numër 15 paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave “A mendoni që prodhuesit vendor e fshehin përmbajtjen e vajit të palmës\* dhe Te cili produkt keni parë përmbajtje të tillë”.

Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të variablave  $\chi^2=19.480$  dhe  $p=0.001$ .

Pasi që  $P=0.001$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99.9% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

4.1.9 A duhet të jenë në raftet e njëjta produktet me vaj palme dhe a duhet të jetë shqetësuese vendosja në raftet e njëjta

**A duhet të jenë këto produkte në raftet e njëjta ? \* A është shqetësuese nëse janë të vendosura në raftet e njëjta?**

			<b>A është shqetësuese nëse janë të vendosura në raftet e njëjta?</b>			
			PO	JO	Mesatarisht	Totali
<b>A duhet të jenë këto produkte në raftet e njëjta ?</b>	Po duhet të jenë në raftet e njëjta	Rezultati	7.7%	92.3%	0.0%	100.0%
	Jo nuk duhet të jenë në raftet e njëjta	Rezultati	61.5%	11.5%	26.9%	100.0%
	Nuk ka rëndësi	Rezultati	3.5%	70.6%	25.9%	100.0%
<b>Totali</b>		Rezultati	24.0%	52.0%	24.0%	100.0%

Tabela 16. A duhet të jenë këto produkte në raftet e njëjta ?\*A është shqetësuese nëse janë të vendosura në raftet e njëjta? (Burimi: Autori)

Tabela 16 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat: A duhet të jenë këto produkte në raftet e njëjta ?\*A është shqetësuese nëse janë të vendosura në raftet e njëjta?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar:

24% prej tyre deklarojnë që Po këto produkte duhet të jenë në raftet e njëjta, dhe prej tyre 7.7% deklarojnë që PO është shqetësuese vendosja në raftet e njëjta, 92.3% prej tyre deklarojnë që JO nuk është shqetësuese.

52% prej tyre deklarojnë që Jo nuk duhet të jenë në raftet e njëjta dhe prej tyre 61.5 % deklarojnë që PO është shqetësuese vendosja në raftet e njëjta, 11.5% prej tyre deklarojnë që JO nuk është shqetësuese dhe 26.9% deklarojnë që Mesatarisht është shqetësuese.



24% prej tyre deklarojnë që nuk ka rëndësi a janë të vendosura në raftet e njejta dhe prej tyre 3.5% deklarojnë që po është shqetësuese vendosja në raftet e njejta, 70.6% prej tyre deklarojnë që jo nuk është shqetësuese dhe 26.9% deklarojnë që mesatarisht është shqetësuese.

### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2- sided)
Pearson Chi-Square	76.325 <sup>a</sup>	4	.000
Likelihood Ratio	85.407	4	.000
Linear-by-Linear Association	13.048	1	.000
N of Valid Cases	150		

*Tabela 17 Testi Hi-Katrorit për variablat . A duhet të jenë këto produkte në rafte të njejta ?\*A është shqetësuese nëse janë të vendosura në rafte të njejta? (Burimi:Autori)*

Në tabelen numër 17 paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave “. *A duhet të jenë këto produkte në rafte të njejta ?\*A është shqetësuese nëse janë të vendosura në rafte të njejta?”*.

Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të variablave  $\chi^2=76.325$  dhe  $p=0.000$ .

Pasi që  $P=0.000$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99.9% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

4.1.10 Cilësia e produkteve të qumështit dhe kush duhet të ofroj më shumë siguri për to

**A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre? \* Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor?**

		Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor?					
			Prodhuesit - Importuesit	Marketet - Tregjet	Shteti me mekanizmat e tij	Të gjithë	Totali
<b>A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre?</b>	Shumë	Rezultati	9	3	14	65	91
			9.9%	3.3%	15.4%	71.4%	100.0%
	Mesatarisht	Rezultati	6	4	21	26	57
			10.5%	7.0%	36.8%	45.6%	100.0%
	Pak	Rezultati	0	1	1	0	2
			0.0%	50.0%	50.0%	0.0%	100.0%
<b>Totali</b>		Rezultati	15	8	36	91	150
			10.0%	5.3%	24.0%	60.7%	100.0%

Tabela 18. A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre? \* Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor? (Burimi: Autori)

Tabela 18 paraqet rezultatet e të dhënave nga variablat: A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre? \* Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor?

Nga analiza e këtyre dy variablave shohim se nga 150 të anketuar:

91 prej tyre deklarojnë që Shumë janë të kënaqur me cilësinë e produkteve që konsumojnë dhe prej tyre 9 apo 9.9% mendojnë që Prodhuesit-Importuesit duhet të ofrojnë më shumë siguri për produktet me vaj bimor, 3 prej tyre apo 3.3% Marketet-Tregjet duhet të ofrojnë më shumë siguri për produktet me vaj bimor, 14 prej tyre apo 15.4% mendojnë që Shteti me mekanizmat e tij duhet të ofrojë më shumë siguri dhe 65 apo 71% mendojnë që Të gjithë sëbashku duhet të ofrojnë më shumë siguri.

57 prej tyre deklarojnë që Mesatarisht janë të kënaqur me cilësinë e produkteve që konsumojnë dhe prej tyre 6 apo 10.5% mendojnë që Prodhuesit-Importuesit duhet të ofrojnë më shumë siguri për produktet me vaj bimor, 4 prej tyre apo 7% Marketet-Tregjet duhet të ofrojnë më shumë

siguri për produktet me vaj bimor, 21 prej tyre apo 36.8% mendojnë që Shteti me mekanizmat e tij duhet të ofrojë më shumë siguri dhe 26 apo 45.6% mendojnë që Të gjithë sëbashku duhet të ofrojë më shumë siguri.

2 prej tyre deklarojnë që Pak janë të kënaqur me cilësinë e produkteve që konsumojnë dhe prej tyre 1 apo 50% mendojnë që Marketet-Tregjet duhet të ofrojë më shumë siguri për produktet me vaj bimor, 1 prej tyre apo 50% mendojnë që Shteti-mekanizmat e tij duhet të ofrojë më shumë siguri.

Ndërsa në total nga 150 të anketuar: 15 apo 10% mendojnë që Prodhuesit-Importuesit duhet të ofrojë më shumë siguri për produktet me vaj bimor , 8 prej tyre apo 5.3% Marketet-Tregjet duhet të ofrojë më shumë siguri për produktet me vaj bimor, 36 prej tyre apo 24 % mendojnë që Shteti me mekanizmat e tij duhet të ofrojë më shumë siguri dhe 91 apo 60.7 % mendojnë që Të gjithë sëbashku duhet të ofrojë më shumë siguri.

#### Chi-Square Tests

	Value	df	Asymptotic Significance (2- sided)
Pearson Chi-Square	21.083 <sup>a</sup>	6	.002
Likelihood Ratio	17.619	6	.007
Linear-by-Linear Association	4.855	1	.028
N of Valid Cases	150		

Tabela 19. Testi Hi-Katrorit për variablat . A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre? \* Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor?(Burimi: Autori)

Në tabelen numër 19 paraqitet Testi Hi Katrorit, ku ky test është shfrytëzuar për të vlerësuar lidhjen në mes të variablave “A jeni të kënaqur me cilësinë e tyre? \* Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor?”

Me anën e këtij testi kemi vërtetuar lidhshmërinë në mes të variablave  $\chi^2=21.083$  dhe  $p=0.002$ .

Pasi që  $P=0.002$  ( $P<0.05$ ) testimi i variablave del që është statistikisht signifikant , atëherë jemi 99.8% të sigurt se ka lidhje të drejtpërdrejt në mes të variablave.

## KAPITULLI V

### 5.KONKLUZIONE

Qëllimi i këtij studimi ishte: Vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik që ndikojnë në vendimin e konsumatorëve për blerjen e produkteve të qumështit me vaj bimor në Rrafshin e Kosovës. Dhe për të arritur tek rezultatet e kërkuara përmes pyetësorit dhe rishikimit të literaturës kemi arritur në përfundim që me rritjen dhe zhvillimin e industrisë ushqimore respektivisht në rastin tonë industrinë e qumështit, është rritur edhe konkurrenca dhe si e tillë industria në fjalë është specializuar në gjetjen e formave për të ardhur deri te një kosto më e lirë dhe më elastike prodhimi. Nga gjetjet e tyre është edhe vaji i palmës i cili ka gjeneruar rezultat të shkëlqyer në përdorimin e tij në prodhimin e produkteve të tyre.

Pasi që vaji i palmës për dallim nga vajrat e tjerë sipasojë e kostos së çmimit dhe mundësisë së gjerë të përdorimit të tij nga viti në vit përdorimi i tij ka shënuar rritje të madhe në nivel global në industrinë konditorike, të qumështit dhe të kozmetikës.

Me rritjen e përdorimit të tij janë shfaqur edhe kundërshtimet për përdorimin e tij dhe si e tillë ka shumë mospajtime mes zingjirit prodhues-përdorues-konsumues.

Qysh në vitin 2003, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) dhe Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) përshkruan provat që lidhin konsumin e yndyrës së ngopur me rritjen e rrezikut të sëmundjes kardiovaskulare si bindëse.

Fakti që vaji i palmës përmban sasi të SFA yndyra të ngopura (~ 50%) e tërhoqi atë në qendër të polemikave me të markuara si një yndyrë që e rrit kolesterolin.

Në vitin 2016, EFSA - Autoriteti Evropian për Siguri Ushqimore ka dhënë opinion për vajrat bimorë të procesuara përfshirë edhe vajin e palmës, për veti kancerogjene dhe gjenogjene, kur ato gjatë procesit të prodhimit të tyre arrijnë trajtimin në temperaturë mbi 200 °C.

Edhe në Kosovë, si në çdo vend tjetër të botës përdorimi i vajrave bimorë në industrinë ushqimore sa shkon dhe rritet nga viti në vit. Në Kosovë ky vaj ka gjetur një përdorim 80% të gjërë për shkak të kostos (më e lirë) në industrinë ushqimore-konditori: prodhimet e çipsit,

biskotave dhe pjekurinave të ndryshme, kurse 20% te prodhimet e qumështit. Nga llojet e vajit bimor që përdoren më së shumti nga këto industri është vaji i palmës.

Produktet të cilat janë të përbëra nga qumështi dhe kanë të zëvendësuar yndyrën shtazore me atë bimore duke e përfshirë edhe vajin e palmës, nuk janë ilegale përderisa deklarohet në etiketë përbërja e produktit dhe produkti si i tillë nuk emërtohet si “qumësht” ose “djath” me ç’rast do të konsiderohej si hutim i konsumatorit

Nga 34 operatorë përpunues të qumështit, sa janë regjistruar në AUV, vetëm shtatë prej tyre janë deklaruar që përdorin vajin e palmës dhe 73 ton është përdor gjatë vitit 2020 tek operatorët e qumështit. Kjo është një problematik pasi që në përmbajtjen e produkteve të tyre nuk paraqitet përmbajtja e vajit të palmës nga shumica e tyre. Nga hulumtimi i këtyre produkteve në raftet e marketeve vetëm nga dy prodhues vendor është gjetur në disa artikuj përmbajtja e vajit të palmës. Andaj shteti duhet të marrë masa urgjente ndaj këtyre prodhuesve të cilët nuk e paraqesin përmbajtjen e vajit të palmës në produktet e tyre.

Problematik tjetër është vendosja e këtyre produkteve sëbashku me produktet me vaj shtazor në raftet e njejtë nëpër markete në Kosovë, andaj kjo duhet rregulluar dhe duhet bërë ndarja e tyre sipas kategorisë në mënyrë që konsumatori të ketë më lehtë identifikimin e tyre.

Konsumatorët që konsumojnë produkte të tilla kanë informacione të mangëta dhe këto informacione i kanë kryesisht nga portalet dhe mediat.

Nga të dhënat e pyetësorit me 150 të anketuar, 8.7% prej tyre këto informacione i kanë nga literatura, 25.3% prej tyre nga mediat dhe gazetat, 34.7% prej tyre nga rrjetet sociale dhe 31.3% prej tyre nuk kanë njohuri.

Shumica e konsumatorëve nuk i kushtojnë rëndësi konsumit të tyre andaj duhet një kampanjë vetëdijësuese nga ana e mekanizmave të shtetit në krye me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, pasi që nga 150 të anketuar: 52% mendojnë që “Po vaji i palmës është i dëmshëm për shëndetin”, 10.7% deklarojnë që “Jo vaji i palmës nuk është i dëmshëm për shëndetin”, dhe 37.3 % deklarojnë që “Nuk kanë njohuri”.

Faktorë tjetër përcaktues në përzgjedhjen e tyre është edhe niveli i të ardhurave që ndikon drejtpërsëdrejti në mundësitë e zgjedhjes së tyre. Ku nga të dhënat e gjeneruara nga pyetësi dalin këto të dhëna në nivelin e përgjithshëm nga 150 të anketuar : 91 prej tyre deklarojnë se të ardhurat e tyre ndikojnë apo 60.7% , 40 prej tyre deklarojnë që nuk ndikojnë apo 26.7% dhe 19 prej tyre deklarojnë se mesatarisht ndikojnë apo 12.7%.

Se sa ndikon përmbajtja e vajit të palmës në produktet që ata i konsumojnë kemi ardhur në përfundim nga të dhënat e pyetësit ku : 48 apo 32% e tyre deklarojnë që: Po ndikon përmbajtja në zgjedhjet e tyre , 45 apo 30% e tyre deklarojnë që Mesatarisht ndikon dhe 57 apo 38% e tyre deklarojnë që Jo nuk ndikon përmbajtja e vajit të palmës.

## REFERENCAT

- Azuan,Z Daud,M Kaur,D & Khosla,P. (a.d.). *Health and nutrition properties of palm oil and its components*. Detroit: Eayne State University.
- Evgjeni Papazisi, I. H. (1996). *Perpunimi i prodhimeve blegtorale*. Tiranë.
- Gap, I. (2016). *Analiza për Industrinë e Qumështit*.  
<https://auvk.rks-gov.net/>. (a.d.).  
<https://dogana.rks-gov.net/>. (a.d.). Gjetur në <https://dogana.rks-gov.net/>  
<https://ëëë.periskopi.com/vaji-palmes-ne-produket-e-qumeshtit-shqetesim-serioz-per-institutin-e-shendetit-publik/>. (a.d.). Gjetur në <https://ëëë.periskopi.com/vaji-palmes-ne-produket-e-qumeshtit-shqetesim-serioz-per-institutin-e-shendetit-publik/>
- Indep. (2015). *indep.info*. Gjetur në [indep.info](https://indep.info/): ( [https://indep.info/ep-content/uploads/publikimet\\_sq/Tregu%20i%20prodhimeve%20të%20qumështit%20dhe%20mundësitë%20e%20Kosovës%20për%20Zhvillim%20%5BBurim%20Ejupi%20%20Dardan%20Abazi%20Dhe%20Gent%20Ahmetaj%2C2015%2008%2C%5D.pdf](https://indep.info/ep-content/uploads/publikimet_sq/Tregu%20i%20prodhimeve%20të%20qumështit%20dhe%20mundësitë%20e%20Kosovës%20për%20Zhvillim%20%5BBurim%20Ejupi%20%20Dardan%20Abazi%20Dhe%20Gent%20Ahmetaj%2C2015%2008%2C%5D.pdf)
- Kadandale, S Martenb,R & Smithc,R. (a.d.). *The palm oil industry and noncommunicable diseases*.
- Miftari, I. (2009). Preferencat e sjelljes konsumatore të Kosovarëve dhe kërkesa për qumësht dhe produkte të qumështit.
- Oi-Ming Lai, Chin-Ping Tan, Casimir C.Akoh. (2012). *Palm Oil*.
- Sowmya Kadandale, R. M. (a.d.). The palm oil industry and noncommunicable diseases.
- Tinker, R. C. (2016). *The Oil Palm*.
- Veterinarisë, A. e. (2018).  
[www.efsa.europa.eu](http://www.efsa.europa.eu). (a.d.). Gjetur në  
[https://ëëë.efsa.europa.eu/sites/default/files/corporate\\_publications/files/161215chemicalsinfoodreport.pdf](https://ëëë.efsa.europa.eu/sites/default/files/corporate_publications/files/161215chemicalsinfoodreport.pdf)
- [www.ekonomiaonline.com](http://www.ekonomiaonline.com). (a.d.). Gjetur në <https://ekonomiaonline.com/ekonomi/biznes/auv-produket-vajin-e-palmes-nuk-jane-ilegale/>
- [www.palmoilinvestigations.org/about-palm-oil.html](http://www.palmoilinvestigations.org/about-palm-oil.html). (a.d.).
- [www.sciencedirect.com](http://www.sciencedirect.com). (a.d.). Gjetur në  
[www.sciencedirect.com/science/article/pii/B9780981893693500216](http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/B9780981893693500216)
- [www.worldstopexports.com/palm-oil-imports-by-country](http://www.worldstopexports.com/palm-oil-imports-by-country). (a.d.).

## ANEKS - PYETËSORI

### PYETËSOR

Të dhënat e mbledhura nga ky pyetësor do të përdoren vetëm si qëllim për punimin e tezës së Masterit për studentin, andaj ju faleminderit që po i kushtoni pak nga koha juaj këtij pyetësori i cili do të më ndihmojë për të zhvilluar tezën me titull:

### Vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik që ndikojnë në vendimin e konsumatorëve për blerjen e produkteve të gumështit me vaj bimor në Rrafshin e Kosovës

Numri i pyetësorit: [ \_\_\_\_\_ ]

Qyteti: : [ \_\_\_\_\_ ]

#### Informacionet kryesore për respondentin

Emri dhe mbiemri:

#### Informacionet e përgjithëshme :

1.Gjinia	1.Mashkull 2.Femër
2.Mosha	1. Deri 18 vjeç 2. 19 - 26 vjeç 3. 27 - 35 vjeç 4. 36 - 45 vjeç 5.Mbi 46 vjeç
3.Niveli i arsimimit	1.Fillor 2.Mesëm 3.Fakultet 4.Master 5.Doktorrat
4.Vendbanimi	1.Qytet 2.Fshat



5. A konsumoni produkte të qumështit ?	1. PO 2. JO
6. Cilat nga produktet e qumështit i konsumoni më shumë?	1. Qumësht 2. Xhizë 3. Kos 4. Jogurt 5. Ajkë 6. Tjetër
7. Në cilat vende i bleni produktet e qumështit ?	1. Supermarkete 2. Tregje 3. Ferma
8. Preferoni më shumë produktet e qumështit vendore apo të importit ?	1. Vendore 2. Importit
9. Cili është faktori përcaktues për përzgjedhjen e produktit vendor apo të importuar ?	1. Cilësia 2. Marka 3. Besueshmëria 4. Origjina
10. A jeni të kënaqur me cilësinë e produkteve të qumështit që konsumoni ?	1. Shumë 2. Mesatarisht 3. Dobët
11. Sa janë të ardhurat mesatare mujore në familjen tuaj ?	1. 100-150 € 2. 150-300 € 3. 300-500 € 4. 500-700 € 5. Mbi 700 €
12. A ndikojnë të ardhurat e juaja në përzgjedhjen e produkteve të qumështit ?	1. Po ndikojnë 2. Jo nuk ndikojnë 3. Mesatarisht ndikojnë
13. Sa janë shpenzimet e juaja në familje për blerjen e produkteve të qumështit ?	1. 5.00 deri 10.00 € / Muaj 2. 10.00 deri 25.00 € / Muaj 3. 25.00 deri 50.00 € / Muaj 4. Mbi 50 € / Muaj

14. Gjatë blerjes së produkteve a e shikoni përmbajtjen e saj ?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. PO</li> <li>2. JO</li> </ol>
15. Cilat janë arsyet që e shikoni përmbajtjen?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Afati skadencës dhe origjina</li> <li>2. Përmbajtja e vajit të palmës</li> <li>3. Të dyjat</li> </ol>
16. A keni informacione për vajrat bimore në veçanti për vajin e palmës?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po kemi informacione</li> <li>2. Mesatarisht kemi informacione</li> <li>3. Jo nuk kemi informacione</li> </ol>
17. Informacionet për vajin e palmës i keni nga cilat burime ?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Literatura</li> <li>2. Mediat dhe gazetat</li> <li>3. Portalet dhe rrjetet sociale</li> <li>4. Nga asnjëra</li> </ol>
18. Nga informacionet që I keni a mendoni se vaji i palmës është i dëmshëm për shëndetin?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po është i dëmshëm</li> <li>2. Jo nuk është i dëmshëm</li> <li>3. Nuk kam njohuri</li> </ol>
19. Cka mund ta bëjë vajin e palmës të dëmshëm për shëndetin e njeriut?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mënyra se si përdoret nga prodhuesit</li> <li>2. Vetit e saja të dëmshme</li> <li>3. Konsumi i shpeshtë</li> <li>4. Nuk kam njohuri</li> </ol>
20. Produktet e qumështit që i bleni a e kanë të përshkruar në përmbajtje vajin e palmës?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po e kanë</li> <li>2. Jo nuk e kanë</li> <li>3. Disa po , disa jo</li> </ol>
21. A ndikon në përzgjedhjen e juaj përmbajtja e produktit me vaj palme?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po ndikon</li> <li>2. Mesatarisht ndikon</li> <li>3. Jo nuk ndikon</li> </ol>
22. Tek cilat produkte më shumë keni parë përmbajtje të vajit bimor-vajit të palmës ?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ajka</li> <li>2. Djathi</li> <li>3. Gjalpi</li> <li>4. Xhiza</li> <li>5. Kaçkavalli</li> <li>6. Nuk kam hasur</li> </ol>

23.Porduktet që bleni me përmbajtje të tillë më shumë janë produkte vendore apo të importit ?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vendore</li> <li>2. Të importit</li> <li>3. Dyjat njejtë</li> </ol>
24.A mendoni që prodhuesit vendor e fshehin përmbajten e vajit të palmës?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po</li> <li>2. Jo</li> </ol>
25.Cila duhet të jetë arsyeja që një prodhues përdorë vajrat bimore – vajin e palmës ?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kostoja më e ulët prodhuese</li> <li>2. Cilësia më e lartë</li> <li>3. Qëndrueshmëria e produktit</li> </ol>
26. Produktet e qumështit me përmbajtje të vajit bimor a duhet ta duhet të gjenden në raftet e njëjta me produktet e qumështit?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po duhet të jenë në raftet e njëjta</li> <li>2. Jo nuk duhet të jenë në raftet e njëjta</li> <li>3. Nuk ka rëndësi</li> </ol>
27.Nëse këto produkte janë të vendosura në raftet e njëjta a duhet të jetë shqetësim për konsumatorin?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Po duhet të jetë shqetësuese</li> <li>2. Jo nuk duhet të jetë shqetësuese</li> <li>3. Mesatarisht duhet të jetë shqetësuese</li> </ol>
27.Kush duhet të ofroj më shumë siguri për produktet me vaj bimor-palme?	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Prodhuesit – Importuesit</li> <li>2. Marketet – tregjet</li> <li>3. Shteti – Agjencia Ushqimit dhe e Veterinarisë</li> <li>4. Të gjithë</li> </ol>

**JU FALEMINDERIT PËR PJESËMARRJEN TUAJ**

# **FALEMINDERIT**